



DORACAKU PËR SISTEMIN E ADRESAVE



PRISHTINË, 2020



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria e Kosovës- Vlada Kosova- Government of Kosovo

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit/ Ministrastvo Ekonomije i

Zivotne Sredine/ Ministry of Economy and Environment

**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA/
KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

Doracak për Sistemin e Adresave

Prishtinë, Tetor 2020

Fjala e Drejtorit Ekzekutiv



Përvojat e shteteve të zhvilluara të Evropës si dhe sfidat me të cilat edhe aktualisht po ballafaqohen shtetet e regjionit në krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të avancuar të adresave tregojnë se kur përmendim termin “adresë” nuk mendojmë në një produkt për të cilin angazhohesh një herë dhe e përfundon, por në një proces shumëdimensional të cilin e krijon dhe

e mirëmban në vazhdimësi. Po ashtu, krijimi i Sistemit të Unifikuar të Adresave kërkon bashkëpunim ndër-institucional dhe bashkëpunim mes institucioneve dhe qytetarëve, sepse një adresë është kualitative vetëm kur përdoret nga institucionet dhe vetëm kur prej saj përfiton qytetari. Mbi këtë, krijimi i adresave kërkon përkrahje politike dhe shoqërore, kërkon financa të bollshme e të rregullta, kërkon ekspertizë vendore e ndërkombëtare krejt me qëllim që të grumbullohen sa më shumë attribute që e bëjnë një adresë të jetë e plotë, si evidentimi i rrugëve në qytete, fshatra e male, digjitalizimi i të njëjtave në sistem, emërtimi i rrugëve nga Kuvendet Komunale, vendosjen e tabelave me emra të rrugëve, vendosjen e numrave të shtëpive dhe mbi gjithçka, inkurajimin e të tjerëve që të përdorin adresat zyrtare.

Sidoqoftë, me përkrahjen profesionale të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe vetë Komunave si dhe me përkrahjen financiare të donatorëve si Zyra e BE-së në Kosovës pjesërisht dhe Qeveria Norvegjeze veçanërisht, deri më tani janë finalizuar adresat unike në shumicën e Komunave. Të njëjtat janë të qasshme për të gjithë përmes gjeoportalit shtetëror, dhe të njëjtat janë duke u përdorur nga kompani të fuqishme ndërkombëtare në fushën e navigimit si TomTom, here.com, Open Street Map, etj. Së fundmi, në kuadër të reformave ligjore brenda AKK-së dhe nevojës për ndryshimin dhe avancimin e kornizës ligjore dhe doracakëve teknik që rregullojnë fushën e adresave, kanë hyrë në fuqi pesë Udhëzimeve Administrative dhe është avancuar ky droacak, e që së bashku kanë ngritur kualitetin e adresave dhe rrjedhimisht edhe kualitetin e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. Qëllimi i reformës ligjore

dhe teknike ka qenë që ti adresojë problemet dhe sfidat dhe të eliminojë ngecjet në mirëmbajtjen më efikase të Sistemit të Adresave nga ana e Komunave, ndërsa konkretisht janë avancuar çështjet e riemërimit të Zonave të Qarkullimit Publik (ZQP) me qëllim të tejkalimit të sfidave që kanë ardhur nga ndryshimet e shpeshta të të adresave rrugëve e ngjashëm, është ndaluar riemërtimi i ZQP-ve për një periudhë kohore prej 10 vjet përpos në disa raste të veçanta, janë obliguar institucionet që të shfrytëzojnë adresat zyrtare, është rregulluar çështja e barazisë gjinore me rastin e emërimit të ZQP dhe është definuar formati unik i tabelave të emrave dhe numrave të adresave e ngjashëm. Për fund, edhe pse besojmë se ky doracak do të lehtësojë punën e institucioneve dhe individëve të përfshirë në mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemit të unifikuar të adresave, i njëjti është dinamik dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës inkurajon të gjitha palët e interesit të cilët ballafaqohen me sfida që nuk mbulohen as nga korniza ligjore e as nga doracak, të adresojnë të gjeturat e tyre, e të cilat pas trajtimit edhe nga profesionistët e Agjencisë, do të merren parasysh e do të përfshihen në versionet tjera eventuale.

Avni AHMETI



Drejtore Ekzekutive e AKK-së

Përmbajtja

Shkurtesat	x
Hyrje.....	1
1. Korniza ligjore në të cilën bazohet sistemi i adresave.....	2
1.1 Ligjet	2
1.2 Udhëzimet Administrative.....	2
2. Funkcioni i adresës	3
2.1 Qëllimi i doracakut.....	6
2.2 Shfrytëzuesit e doracakut.....	6
3. Zbatimi i sistemit të adresave	6
4. Roli dhe përgjegjësitë në krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të adresave ..	7
4.1 Roli dhe përgjegjësitë e Ministrive	7
4.2 Roli dhe Përgjegjësitë e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.....	8
4.3 Roli dhe përgjegjësitë e Komunës.....	9
4.4 Roli dhe përgjegjësia e qytetarëve.....	10
4.5 Roli dhe përgjegjësia e operatorëve ekonomik	10
4.6 Komunikimi ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror	11
4.7 Përdorimi i informacionit gjeografik.....	11
5. Emërtimi.....	12
5.1 Parimet kryesore.....	12
5.2 Konfigurimi i rrjetit rrugor	13
5.3 Fillimi dhe mbarimi i ZQP.....	16
5.4 Prioriteti i ZQP	18
5.5 Kodi dhe segmentet e ZQP	19
5.6 Kalimi ZQP nëpër disa njësi administrative.....	20
6. Numërtimi.....	23
6.1 Parimet kryesore	23
6.2 Përcaktimi i vendndodhjes së hyrjes në objekt.....	23
6.3 Drejtimi i numërimit	26

6.4	Numrat e adresave çift dhe tek	27
6.5	Hyrja në objekt	28
6.6	Numrat rezervë	31
6.7	Adresa me numër dhe shkronjë	34
6.8	Numri i adresës me numër dhe fraksion.....	35
6.9	Kryqëzimi i rrugëve	36
6.10	Transformimi i objekteve	37
6.11	Sheshet.....	38
6.12	Korrespondimi i numrave të adresës.....	40
6.13	Rrugët me një dalje – jo emërtim	41
6.14	ZQP në formë harku	42
6.15	Objektet me disa hyrje.....	43
6.16	Ambiente me funksione jo-banimi	47
6.17	Objekte brenda një muri rrethues	47
6.18	Rrugët me një dalje - me emër më vete.....	48
6.19	Ndërtesat e grupuara.....	51
6.20	Qendër tregtare/biznesi	52
6.21	Numërtimi i banesave/zyrave	53
6.22	ZQP që kalon nëpër disa komuna	55
6.23	Zonat rurale	56
6.24	Organizimi i punës në grupe.....	58
7.	Mirëmbajtja e sistemit të adresave	58
7.1	Caktimi i adresës së re	58
7.2	Ndryshimi i adresës të re	59
8.	Regjistri i adresave.....	59
8.1	Elementet e një adrese në regjistrin e adresave	60
9.	Cikli i jetës së adresave	62
9.1	Cikli i adresave/Objektit	63
9.2	Cikli i një zone të qarkullimit publik.....	63
10.	Vendosja e tabelave të emrave të ZQP-ve dhe numrave	64

10.1	Parimet kryesore për tabelat e emrave	65
10.2	Parimet kryesore për tabelat e adresave	66
11.	Shtojcë: Forma e Certifikatës së Adresës	66

Lista e Figurave

Figura 1. Elementet e Adresës	3
Figura 2. Llojet e regjistrave	4
Figura 3. Disa nga objektet e adresueshme.....	5
Figura 4. Konfigurimi i rrjetit rrugor	14
Figura 5. Përcaktimi i ZQP-ve në bazë të ngjyrës dhe emrit.....	15
Figura 6. Fillimi dhe mbarimi i ZQP-ve.....	16
Figura 7. Kryqëzimi i rrugëve kryesore nga bulevardi	17
Figura 8. Prioriteti i adresimit të ZQP-ve	18
Figura 9. Kodi dhe segmentet e ZQP-ve	19
Figura 10. Vargu i adresave për një segment	20
Figura 11. Kalimi i ZQP nëpër disa komuna	20
Figura 12. Emërtimi i ZQP-së e cila kalon nëpër dy komuna	22
Figura 13. Evidentimi i objekteve në terren të cilat nuk gjenden në hartë.....	24
Figura 14. Evidentimi i hyrjeve që kanë dalje në një ZQP	25
Figura 15. Shenjëzimi i hyrjeve që kanë dalje në një ZQP	26
Figura 16. Numrat e adresave çift dhe tek	27
Figura 17. Numrat e adresave kur objektet e adresueshme ndodhen vetëm në njërën anë të ZQP	28
Figura 18. Ndërtësë banimi me dy hyrje	29
Figura 19. Adresimi i objektit i cili është ndarë në dy pjesë	29
Figura 20. Numërtimi i hyrjeve në rastet kur jo të gjitha hyrjet ndodhen në një krah të objektit	30
Figura 21. Parcelat kadastrale të lira	31
Figura 22. Numrat rezervë për parcelat kadastrale të lira	32
Figura 23. Numrat rezervë për trojet (parcelat) e lira	33
Figura 24. Hapësirë e lirë e cila nuk është e dedikuar për ndërtim.....	34
Figura 25. Situata e adresimit para dhe pas ndryshimit të bërë në objekt	35
Figura 26. Kryqëzimi i 3 rrugëve me emra të ndryshëm	37
Figura 27. Transformimi i grup shtëpive në një ndërtësë kolektive.....	38
Figura 28. Numërtimi i shesheve	39
Figura 29. Korrespondimi i numrave të adresave në të dy anët e ZQP-së	40
Figura 30. Numërtimi i hyrjeve në rrugët me një dalje	41
Figura 31. Numërtimi i hyrjeve në rrugët me një dalje	42
Figura 32. Numërtimi i rrugëve në rrugët në formë harku.....	42
Figura 33. Numërtimi i rrugëve në rrugët në formë harku.....	43
Figura 34. Numërtimi i një objekti me disa hyrje dhe me dalje në ZQP të njëjtë	44
Figura 35. Numërtimi i një objekti me disa hyrje	44
Figura 36. Numërtimi i një objekti me disa hyrje dhe dalje në katër ZQP të ndryshme	45
Figura 37. Numërtimi i objekteve të cilat kanë dalje në më shumë.....	46
Figura 38. Numërtimi i lokaleve - bizneseve.....	47
Figura 39. Numërtimi i objekteve brenda një muri rrethues	48

Figura 40. Emërtimi i ZQP me një dalje dhe numërtimi i hyrjeve në këto rrugë.....	49
Figura 41. Emërtimi i ZQP me një dalje dhe numërtimi i hyrjeve në këto rrugë.....	50
Figura 42. . Numërtimi i grup objekteve te cilat gjenden njëri pas tjetrit.....	51
Figura 43. Numërtimi i një qendre tregtare me një hyrje	52
Figura 44. Numërtimi i një qendre tregtare me shumë lokale dhe hyrje.....	53
Figura 45. Numërtimi i banesave dhe zyrave	54
Figura 46. Numërtimi i banesave dhe zyrave brenda një kati.....	54
Figura 47. Numërtimi i objekteve në rrugët të cilat kalojnë nëpër disa komuna	55
Figura 48. Numërtimi i objekteve në zonat rurale	57
Figura 49. Numërtimi i objekteve në zonat me dendësi të vogël të shtëpive.....	57

Shkurtesat

MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
MAPL	Ministria e Pushtetit Lokal
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
SRA	Spektori i Regjistrimit të Adresave
ZPU	Zyrat e Planifikimit Urban
ZKK	Zyra Kadastrale Komonale
UA	Udhëzim Administrativ
RSHA	Regjistri Shtetëror i Adresave
RKA	Regjistri Komunal i Adresave
ZQP	Zona të Qarkullimit Publik
SIRA	Sistemi Informativ i Regjistrimit të Adresave
GPS	Sistemi i pozicionimit global
PKL	Parcela Kadastrale të Lira
OE	Operatori Ekonomik

Hyrje

Mungesa e një sistemi të avancuar, unik, digjital e zyrtar të adresave për një kohë të gjatë ka shkaktuar vështirësi në ofrimin e shërbimeve kualitative dhe të shpejta për institucionet dhe qytetarët e Republikës së Kosovës. Për të tejkaluar këtë sfidë Agjencia Kadastrale e Kosovës me përkrahje nga Zyra e BE-së në Kosovë, në vitin 2010 ka lancuar projektin për krijimin e Sistemit të Unifikuar të Adresave ndërsa përkrahja për të ka vazhduar për vite me rradhë, e vazhdon edhe sot, nga Autoriteti Norvegjez për Hartografi (Staten Kartverk).

Procesi i krijimit të Sistemit të Unifikuar të Adresave ka qenë sfidues dhe shumëdimensional ndërsa si hap i parë, pas pilotimit të Sistemit të Unifikuar të Adresave, ishte krijimi i bazës ligjore, në të cilën u përfshinë definicionet e parimeve të adresave, së bashku me përgjegjësitë përkatëse. Korniza ligjore ishte dinamike dhe e njëjta ka pësuar ndryshime, varësisht prej zhvillimeve dinamike në terren dhe nevojave të palëve të ndryshme të interesit. Rjedhimisht, sot e njëjta është ndër më të avancuarat në regjion.

Krijimi i kornizës ligjore u pasua me punën në terren në nivel shtetëror, përmes angazhimit të rreth 200 ekspertëve dhe përmes përfshirjes së Zyrave të Planifikimit Urban në nivel lokal, e që së bashku me Agjencinë Kadastrale të Kosovës si bartëse e procesit ia dolën që për një kohë optimale të përfundojnë identifikimin dhe digjitalizimin e mbi 20.000 rrugëve dhe identifikimin dhe digjitalizimin e mbi 400.000 hyrjeve të shtëpive/ndërtesave/objekteve në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Më pas, me qëllim të lehtësimit të administrimit dhe mirëmbajtjes së adresave u zhvillua web aplikacioni “Sistemi Informativ për Regjistrin e Adresave”, u ngritën kapacitete profesionale nëpër komuna, u themelua sektori për sistemin e adresave në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, etj.

Me kompletimin e Sistemit të Adresave Republika e Kosovës gjithashtu ka plotësuar një prej standardeve Evropiane për liberalizim të vizave, plotësohet Direktiva INSPIRE 2007/2 e BE-së që parasheh krijimin, ofrimin/publikimin e të dhënave gjeo-hapësinore, përfshi edhe adresat, mundësohet lidhja e bazës së të dhënave me adresa mes institucioneve të ndryshme përfituese si Agjencia e Regjistrimit Civil, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Bankat, Gjykata, Policia, Emergjencia etj. Prandaj, lirisht mund të arrihet në përfundim se krijimi dhe mirëmbajtja e sistemit unik të adresave është një nga shërbimet më të rëndësishme që pushteti lokal dhe qendror i siguron

qytetarëve të Kosovës., ndërsa për të lehtësuar procesin e krijimit dhe mirëmbajtjes së adresave, si dhe për të definuar qartë përgjegjësitë e instucioneve për krijimin dhe mirëmbajtjen e adresave, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka nxjerrë edhe Doracakun për Sistemin e Adresave i cili në vijim u prezantohet në versionin e azhurnuar dhe pas implementimit të komenteve e sugjerimeve të palëve të ndryshme të interesit.

1. Korniza ligjore në të cilën bazohet sistemi i adresave

Krijimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të Adresave bazohet në kornizat ligjore, duke filluar nga Ligji për Sistemin e Adresave, i cili e rregullon procesin e krijimit, mirëmbajtjes, zbatimit, administrimit etj. të Adresave në Kosovë, pastaj Ligji për Vetëqeverisje Lokale, i cili rregullon përgjegjësitë e Komunave përkitazi me Emërtimin e ZQP-ve, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare i cili rregullon përdorimin e gjuhëve përkitazi me emrat e rrugëve, Ligji mbi rrugët, i cili rregullon çështjen e llojeve të ZQP-ve dhe Ligji për Kadastrin, i cili rregullon përgjegjësitë rreth të dhënave Gjeohapësinore dhe organizmin e brendshëm të AKK-së, e më pastaj udhëzimet administrative të cilët rregullojnë më detajisht metodologjinë e adresimit në Kosovë. Më poshtë janë paraqitur ligjet dhe udhëzimet administrative në të cilat bazohet Sistemi i Adresave në Kosovë.

1.1 Ligjet

- Ligji Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave
- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale
- Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve
- Ligji Nr. 2003/11 mbi Rrugët
- Ligji Nr. 04/L-013 për Kadastër

1.2 Udhëzimet Administrative

- Udhëzimi Administrativ për renditjen e elementeve të adresave dhe caktimin e formatit të shkronjave, numrave dhe të tabelave të adresave;
- Udhëzimi Administrativ për caktimin e emërimit dhe numërimit të adresave për zona të qarkullimit publik, ndërtesa, shtëpi, objekte dhe parcela kadastrale të lira;

- Udhëzimi Administrativ për vendosjen fizike të tabelave të adresave në zona të qarkullimit publik, ndërtesa, shtëpi, objekte dhe parcela kadastrale të lira;
- Udhëzimi Administrativ për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezerve dhe vendosjen e tyre në Regjistrin Komunal të Adresave;
- Udhëzimi Administrativ për procedurat e krijimit dhe administrimit të Regjistrit Komunal të Adresave dhe Regjistrin Shtetëror të Adresave

2. Funkzioni i adresës

Shumica e bazave së të dhënave publike apo private dhe regjistrat themelorë i referohen informatave nga regjistri i adresave. Zonat e Qarkullimit Publik (ZQP) janë të frekuentuara dhe gjithnjë kërkojnë adresa funksionale.

Funksionet e adresës janë të shumta dhe më të rëndësishmet në shoqëri, janë radhitur në vijim:

- Adresa është një mënyrë për të gjetur personin,
- Gjetja e adresës së banimit,
- Emri i komunës, numri i banesës, emri i vendbanimit,
- Gjetja e selisë së kompanisë,
- Gjetja e ndërtesave (adresa e objektit),
- Kërkimi i informatave përkatëse në regjistrat publikë, privatë,
- Hulumtimi i arkivit të caktuar në mënyrë të sistemuar etj.




Figura 1. Elementet e Adresës

Adresat ofrojnë lehtësira në regjistrin civil, shërbimet publike, në transport, navigacion në veturë, në polici, në forcat e sigurisë, tek zjarrfikësit, emergjenca, gjykata, posta dhe ofrimi i shërbimeve tjera për qytetarët. Adresat gjithashtu shërbejnë si mjet referimi për kërkimin e dokumenteve të ndryshme shtetërore. Kjo do të thotë që adresa përfshihet në pothuajse të gjitha dokumentet zyrtare, që nga lejet e ndërtimit e deri tek vërtetimi i pronësisë, nga kontratat tek vendimi i një gjykatësi, e nga patentë shoferi deri tek pasaporta.

Sistemi i regjistrimeve në regjistrin përkatës mbështetet në adresat ekzistuese si burim identifikimi. Për këtë dhe arsye të tjera, adresa ka rolin e veçantë në proceset e regjistrimeve në të ardhmen e afërt. Disa nga regjistrimet e kërkuara të cilat realizohen nëpërmjet zyrës përkatëse të pushtetit lokal apo qendror janë paraqitur në vijim në fig. 2.



Figura 2. Llojet e regjistrave

Informacioni jo i saktë i adresës bazuar në dokumentin aktual, ku ekzistojnë adresa të ndryshme për të njëjtin lokacion vështirësojnë regjistrimet dhe lidhjet me njëri tjetrin. Këto vështirësi shprehen me probleme të ndryshme si në përditësimin e të dhënave, vështirësi në çasje dhe shfrytëzim korrekt të tyre. Pra, është shumë e rëndësishme që të gjitha llojet e regjistrimeve të punojnë vetëm me një databazë adresash dhe qytetarët përherë të kenë vetëm një adresë të shfrytëzueshme dhe të përditësuar, si adresë e saktë, unike dhe zyrtare e tyre. Në Republikën e Kosovës, sistemi i adresave deri më tani shpesh ka pasur një rol komplikimi, ngase janë përdorur disa adresa për të njëjtën rrugë apo

lokacion, e që krijonin konfuzion. Disa adresa për të njëjtin lokacion ishin si rrjedhojë e sundimit të sistemeve të ndryshme politike në Kosovë, të cilat sisteme i ndërronin adresat duke vënë emra rrugësh, sheshesh e lokacionesh sipas interesit momental, pa ndonjë rregullore.

Adresa duhet të jetë e njëjtë në të gjitha regjistrimet siç është paraqitur në fig. 2, të cilat gjithsesi u referohen objektit, pjesëve të objektit apo grupeve të ndryshme të objekteve. Pra nuk është e mjaftueshme që të sigurohemi që të njëjtat adresa të përfshihen në të gjitha regjistrimet. Përveç kësaj, adresat duhet t’iu referohen objekteve të njëjta.

Nëse në këto regjistra përpunohen adresa të pasakta apo adresa të vjetra nga periudha të ndryshme kohore, si u cek më lartë, kjo do të çojë në gabime të regjistrimit, që njëkohësisht krijon pasoja të padëshiruara për marrjen dhe shkëmbimin e informacionit.

Çasja në të dhënat e adresave është e rëndësishme për shërbimet e institucioneve qendrore dhe në veçanti institucioneve lokale. Që nga nxjerrja e një informacioni nga regjistri i gjendjes civile, tek marrja e informacionit nga tatimi për pasurinë e paluajtshme, e deri tek marrja e informacionit për regjistrimin e tokës – qytetarët dhe institucionet duhet pothuajse gjithmonë që të japin një adresë unike. Çdo objekti të adresueshëm i caktohet një adresë – qoftë ky objekt i ndërtuar me leje ndërtimi formal apo pa leje ndërtimi - joformal.

Nëse gjatë procesit të zhvillimit urbanistik është krijuar një objekt, atëherë ky duhet të marrë një adresë. Adresa në vetvete nuk mund të jetë e ligjshme apo e paligjshme. Nëse objekti është i pa legalizuar dhe vendoset të shembet pas një kohe të caktuar,

atëherë edhe adresa mbyllet gjatë këtij procesi. Me dhënien e adresës për një objekt joformal, në këtë rast nuk nënkupton edhe legalizimin e objektit. Me dhënien e adresës,




Figura 3. Disa nga objektet e adresueshme

banorit i jepet mundësia që të ketë një çasje në sistemin e adresës, të marrë shërbime e të jetë i gjetshëm për sa kohë që ai jeton në atë objekt. Pajisja e të gjitha

ZQP me tabela dhe pajisja e të gjitha objekteve të adresueshme me numër adrese do t'ju ofrojë qytetarëve, bizneseve, administratës shtetërore etj., informacion të dukshëm dhe të saktë mbi adresat. Në fig.3 janë paraqitur disa lloje të objekteve të adresueshme me funksion dhe shfrytëzim të ndryshëm si ndërtesë banimi individuale apo kolektive, institucione, shtëpi banimi, objekt biznesi, etj.

2.1 Qëllimi i doracakut

Ky doracak ka për qëllim të ndihmojë zyrtarët në komuna për zbatimin e Ligjit nr.04/L-071 dhe Udhëzimeve Administrative për Sistemin e Adresave, në mënyrë saktë dhe të unifikuar në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Është e rëndësishme që doracaku të përdoret si shtojcë e bazës ligjore duke ofruar informacion shtesë, shembuj dhe ilustrime konkrete për caktimin e emrave dhe adresave, në mënyrë që sistemi i adresave të jetë lehtësisht i zbatueshëm dhe i thjeshtë për t'u përdorur nga të gjithë.

2.2 Shfrytëzuesit e doracakut

Doracaku për sistemin e adresave në Republikën e Kosovë është për përdorim të gjerë dhe shumë-dimensional nga punonjësit në Drejtorinë përgjegjëse të Planifikimit Urban në Komunë, Drejtoritë për shërbime të tjera civile në Komunë, Asamblетë Komunale të cilat janë të përfshira në procesin e emërimit të ZQP-vë, përcaktimin e adresave, menaxhimin e sistemit, vendosjen e tabelave dhe shenjave të tjera. Gjithashtu doracaku do të jetë material bazë për trajnimin e punonjësit apo punonjësve të rinj që do të punojnë në përditësimin e sistemit të adresave. Po ashtu doracaku do t'u shërbejë të gjitha subjekteve të tjera të ndërlidhura apo të interesuara për sistemin e adresave.

3. Zbatimi i sistemit të adresave

Sipas Ligjit për Sistemin e Adresave në Kosovë çdo Komunë do të ushtrojë detyrën për përcaktimin dhe regjistrimin e adresave.

Komunat kanë autoritetin të ndryshojnë apo tërheqin një numër adrese apo emërtimet e ZQP. Komunave do t'u jepen instrumentet e duhura (baza ligjore, udhëzimet administrative, doracaku për adresat, aplikacioni për sistemin e adresave (SIRA), trajnime, hartat vektoriale dhe ortofotot që të kryejnë detyrën

për të cilën janë përgjegjëse.

Komuna mund të krijojë një njësi të re adresash brenda strukturës së saj ose të ngarkojë një zyrtar të adresave që të merret me menaxhimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e sistemit të adresave dhe informimin e qytetarëve. Kjo njësi mund të jetë pjesë ose të jetë nën varësinë e Drejtorisë të Planifikimit Urban me qëllim që gradualisht të integrohet si një nga shërbimet që kryen Komuna ndaj qytetarëve dhe subjekteve private.

Realizimi i sistemit të adresave përbëhet nga 2 (dy) faza kryesore:

- I. **Faza e zbatimit:** në këtë fazë, pjesa më e madhe e financimit dhe e punës është përqendruar në të gjithë punonjësit e administratës publike të përfshirë në krijimin e sistemit të ri të adresave. Ata duhet të jenë të angazhuar dhe të motivuar që të krijohet një sistem i saktë i adresave duke pëmbushur standardet me qëllim që të zbatohet sa më shpejt që të jetë e mundur.
- II. **Faza e mirëmbajtjes:** pasi sistemi i adresave është ngritur dhe në ndërkohë pjesa më e madhe e punës është përfunduar, detyra kryesore qëndron në sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit të adresave në nivel të komunës dhe në nivel shtetëror. Administrimi dhe përpunimi i të dhënave të adresave bëhet në aplikacionin SIRA.

4. Roli dhe përgjegjësitë në krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të adresave

Bazë për implementimin dhe zbatimin e suksesshëm të Sistemit të Adresave, është angazhimi, bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve të gjithë akterëve të përfshirë, duke filluar nga Ministritë përkatëse (MEA, MAPL, AKK, komunat, qytetarët, e deri tek operatorët ekonomik).

Roli dhe përgjegjësitë e akterëve janë të përcaktuara më kornizën ligjore.

Në vijim janë të paraqitur përgjegjësitë e akterëve:

4.1 Roli dhe përgjegjësitë e Ministrive

- Ministria përgjegjëse për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor (aktualisht Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit) në

bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Qeverisje Lokale, Ministrinë përgjegjëse për Punë të Brendshme dhe Komunitet janë përgjegjëse për zbatimin e tërë Sistemit të Adresave në Republikën e Kosovës.

- Ministria siguron koordinim ndërmjet institucioneve qeveritare dhe komunale dhe siguron mundësi teknike dhe financiare për zbatimin uniform të sistemit të adresave.
- Ministria është përgjegjëse për shqyrtimin e emërtimeve të vendosura nga Komunitet për zonat e qarkullimit publik dhe t'i njoftojë komunitet në rast të shkeljes së këtij ligji.
- Ministria krijon dhe administron Regjistrin Shtetëror të Adresave.
- Ministria shpërndanë të dhënat nga Regjistri Shtetëror i Adresave në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
- Ministria dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës sigurojnë harta, Udhëzime Administrative, doracakë dhe udhërrëfyes të përshtatshëm për Komunitet në mënyrë që të fillojnë zbatimin e Sistemit të Adresave.

4.2 Roli dhe Përgjegjësitë e Agjencisë Kadastrale të Kosovës

AKK është përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e Regjistrit Shtetëror të Adresave. Përgjegjësitë e AKK-së janë:

- Krijon Sektorin e Adresave në kuadër të AKK-së;
- Siguron zbatimin unik të sistemit të adresave në të gjitha ZPU-të e Republikës së Kosovës,
- Vlerëson punën e ZPU-ve në lidhje me mirëmbajtjen e regjistrit të adresave;
- Përgatit doracakët për ZPU-të për të mundësuar operimin e sistemit të adresave në gjuhët zyrtare;
- Siguron funksionimin e sistemit të adresave;
- Koordinon me institucione tjera shpërndarjen e të dhënave të Regjistrit të Adresave;
- Mundëson trajnime periodike për zyrtarët e ZPU-ve që kanë çasje në regjistrin komunal të adresave;
- Mundëson lidhjen e të dhënave të regjistrit të adresave me të dhëna të institucioneve të tjera, ku përdorimi i adresave është i nevojshëm;

- Monitoron procesin e vendosjes së tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të adresave.
- Planifikon buxhetin e nevojshëm për mirëmbajtjen e sistemit të adresave.

4.3 Roli dhe përgjegjësitë e Komunës

Komuna, përmes Zyrës së Planifikimit Urban, është përgjegjëse për krijimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit Komunal të adresave. Në vijim janë listuar përgjegjësitë e Komunës:

- Komuna cakton emrat dhe numrat e veçantë për të gjitha objektet, ndërtesat, banesat, dhe parcelat kadastrale të lira, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
- Të gjitha elementet e adresës në Komunë regjistrohen dhe mirëmbahen nga stafi ekzistues i drejtorisë përgjegjëse në regjistrat komunale të adresave në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
- Komuna nuk lëshon leje ndërtimi përveç nëse është caktuar adresa dhe është përfshirë në lejen e ndërtimit.
- Komuna koordinon proceset e emërtimeve dhe numërtimeve me komunën fqinje në rast të zonave ndër-komunale të qarkullimit publik.
- Komuna njofton pronarët e pronave dhe banorët për emrin dhe numrin e zonës së qarkullimit publik në të cilën ata banojnë.
- Komuna është përgjegjëse për sigurimin dhe vendosjen e tabelave me emra dhe numra për të gjitha zonat ekzistuese të qarkullimit publik, në përputhje me Ligjin dhe udhëzimet administrative.
- Komuna është përgjegjëse për sigurimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha tabelave me emra, brenda territorit të saj.
- Komuna përgatitë specifikacionet teknike për prodhimin dhe instalimin e tabelave të emrave të ZQP-ve dhe numrave adresave, në konsultim me AKK-në, duke u bazuar në Ligjin dhe udhëzimet administrative.
- Komuna inspekton procesin në mënyrë të përhershme në teren të vendosjes së tabelave të emrave të ZQP-ve dhe numrave të adresave, duke caktuar lokacionin e vendosjes së shtyllave dhe tabelave.
- Komuna mirëmban të dhënat në Regjistrin Komunal të Adresave duke siguruar që të gjitha të dhënat janë të plota, korrekte dhe të përditësuara

- Krijon njësinë e adresave ose cakton zyrtarin e adresave në kuadër të ZPU-së.
- Krijon dhe mirëmban regjistrin komunal të adresave në regjistrin komunal, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës në alfabetin latin.
- Përditëson të dhënat tekstuale të adresave përmes SIRA së paku një herë në vit.
- Komunikon rregullisht me AKK-në për çdo ndryshim të bërë në regjistrin komunal të adresave.
- Lëshon certifikatë të adresave zyrtare të gjeneruar nga SIRA, e cila mund të përdoret si dëshmi para institucioneve, sipas kërkesës së qytetarëve.
- Informon dhe mundëson shpërndarjen e të dhënave tekstuale të adresave me institucionet lokale.

4.4 Roli dhe përgjegjësia e qytetarëve

Roli i qytetarëve në krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të adresave është shumë i madh. Roli i qytetarëve konsiston në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit të emërimit të ZQP-ve, duke i ndihmuar komisionit në dhënien e propozimeve adekuata për ZQP të caktuara. Rol tjetër me rëndësi është edhe prezenca e tyre gjatë realizimit të procesit të vendosjes së tabelave me emra dhe numra, duke krijuar kushtet e nevojshme Komunës dhe operatorit ekonomik në vendosjen e shtyllave dhe tabelave. Rol tjetër shumë me rëndësi është edhe shfrytëzimi i adresave zyrtare, duke lajmëruar adresën zyrtare në secilin institucion që kërkon shërbime dhe kërkohet adresa. Gjithashtu me rëndësi është edhe kërkesa për adresë të re me rastin e ndërtimit të objektit të ri, i cili mundëson përditësimin e adresave.

4.5 Roli dhe përgjegjësia e operatorëve ekonomik

Roli dhe përgjegjësia e operatorëve ekonomik, buron nga baza ligjore (ligji dhe udhëzimet administrative), specifikave teknike dhe kontratat. Roli i OE është vetëm gjatë procesit të prodhimit dhe instalimit të tabelave të ZQP-ve dhe adresave. OE prodhon tabelat sipas bazës ligjore, specifikave teknike dhe kontratës dhe realizon punët në teren, bënë instalimin e tabelave sipas kriterëve të përcaktuara dhe gjithnjë sipas instruksioneve të zyrtarëve komunal, të cilët

japin udhëzime për lokacionin e vendosjes së shtyllave dhe tabelave të ZQP-ve dhe numrave të adresave.

4.6 Komunikimi ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror

Në krijimin e sistemit të ri të adresave, është shumë i rëndësishëm komunikimi në mes të administratës në nivel qendror dhe administratës në nivel lokal. Ky komunikim është një prej faktorëve kryesor që dërgon drejt suksesit. Vënia në funksion të një sistemi të ri të adresave kërkon pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve që kanë përgjegjësi në këtë proces. Palë shumë me rëndësi janë edhe shfrytëzuesit e adresave zyrtare dhe unike. Vetëm atëherë kur adresat shfrytëzohen edhe krijohet vlera e të dhënave të adresave, mundësohet përditësimi i tyre.

Komunikimi ndërmjet Zyrave të Planifikimit Urban, ZKK-ve dhe shërbimeve publike brenda Komunës është thelbësor, po ashtu edhe mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me Komuna të tjera. Çdo Komunë duhet të paraqesë vështirësitë që ndeshen gjatë punës apo të japë sugjerime të vlefshme në lidhje me implementimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të adresave. Përveç implementimit të sistemit dhe mirëmbajtjes në mënyrë të vazhdueshme të sistemit të adresave, rëndësi të madhe ka edhe shfrytëzimi i adresave zyrtare ku nëpërmjet informimit publik përmes formave të ndryshme mundësohet ndërgjegjësimi i qytetarëve se sa i dobishëm dhe i rëndësishëm është sistemi i adresave për vetë qytetarët dhe institucionet.

4.7 Përdorimi i informacionit gjeografik

Menaxhimi afatgjatë i sistemit të adresave bazohet në materialet ekzistuese d.m.th. në harta të shkallëve të ndryshme, në ortofoto me rezolucion të mjaftueshëm për qartësimin e detajeve për sistemin e adresave, por edhe në ato materiale që krijohen në të ardhmen e që shërbejnë për sistemin e adresave. Secila komunë për territorin e saj duhet të ketë si material bazë ortofoton/ hartën më të re të territorit të tyre në letër dhe në formë digjitale. Në hartë të tregohen pjesët e përbashkëta të infrastrukturës së komunave rreth tyre me të cilat kanë kufij të përbashkët. Ky informacion ndihmon në zgjidhjen e situatave që hasen në emërtimin e ZQP dhe numërtimin e objekteve në zonat kufitare ndërmjet dy apo më shumë komunave.

Për procesin e adresimit është i domosdoshëm përdorimi i informacionit

hartografik i përditësuar për gjithë territorin e Republikës së Kosovës në format raster apo vektor në mënyrë që të identifikohen të gjitha ZQP me emërtimet e tyre përkatëse dhe të gjitha objektet e adresueshme të cilave do t'u caktohet një adresë në lidhje me ZQP përkatëse. Informacioni hartografik luan rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin e adresave në mënyrë që të gjitha komunat të punojnë me të njëjtin burim informacioni. Agjencia Kadastrale e Kosovës siguron dhe shpërndanë komunave të dhënat gjeohapësinore përmes Gjeoportalit shtetëror por edhe të dhënat tjera vektoriale për të cilat është e mundur shpërndarja.

Informacioni hartografik duhet të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga stafi i Drejtorisë përgjegjëse për Planifikim Urban pranë çdo komune në mënyrë që të kemi një informacion gjithmonë të përditësuar, të saktë për caktimin e adresave ku të jenë evidente të gjitha ndërtesat dhe ZQP ekzistuese dhe të reja.

Të gjitha ndryshimet si p.sh ZQP të reja, zona banimi të reja, ndryshime të emërtimeve apo numrave të adresave që mund të ndodhin në të ardhmen duhet të pasqyrohen në regjistrin e adresave duke siguruar një sistem adresash të saktë dhe të besueshëm.

5. Emërtimi

Emërtimi është një proces ndërlikuar që kërkon punë dhe vëmendje për t'u realizuar ashtu siç kërkohet. Ky proces duhet të bazohet në kriteret e dhëna në Ligj dhe në UA të miratuara.

5.1 Parimet kryesore

Referuar Kreut II në Ligjin nr.04/L-071 dhe në Udhëzimin Administrativ MMPH nr. 14/2019 për Sistemin e Adresave, lidhur me emrat e rrugëve ekzistuese, të reja dhe emrat e mbajtur në listën rezervë, të miratuar më parë nga komuna për përdorim në të ardhmen, me poshtë jepen disa nga parimet kryesore të ilustruara me shembuj që duhen të merren parasysh gjatë procesit të emërtimit dhe ri-emërtimit:

- Nuk lejohet ri-përdorimi i emrave të vjetër të ZQP;
Bazuar në faktin që në Kosovë janë bërë disa herë ndryshime të emrave të rrugëve është mirë që emrat e vjetër të hiqen nga përdorimi për të shmangur

problemet.

- Nuk lejohet përdorimi i emrave me fonetikë të dyfishtë;
Emrat e rinj nuk duhet të jenë identik ose të ngjashme në shqiptim me ndonjë emër të rrugës ekzistuese; p.sh Rruga Arbenia dhe Rruga Arbëria Rruga Andoni dhe Rruga Antoni.
- Emrat me një shkronjë apo vetëm me numër nuk lejohen si emër bazë në emërtimin e ZQP, p.sh Rruga A apo Rruga 52, Rruga 1944.
- Nuk lejohet përdorimi i emrave me shkurtesa apo initiale;
Rruga U.N.D.P apo Rruga F.S. Noli.
- Nuk lejohet përdorimi i emrave në gjuhë të huaj;
Emrat në gjuhë të huaj lejohen vetëm nëse ato përshtaten në gjuhën shqipe, p.sh Rruga Riverside.
Emri dhe mbiemri i figurave të shquara që kanë kontribuar në zhvillimin e Kosovës do të përshtaten me shkronjat e alfabetit shqip, p.sh. Bill Klinton dhe jo Bill Clinton
- Nuk lejohen karaktere speciale, të tilla si: vizë, apostrof, pika ose thonjëza;
Të shmangen këto raste të të shkruarit: RR:, RR. V. SINA , rr. skender _luarasi, Rruga: “Sami Frashëri”, Rruga Prizren-Kukës
- Emërtime me gabime gjuhësore;
- Emrat e sugjeruar duhet të kenë 1 ose 2 fjalë dhe duhet të shmangen emrat me më shumë se dy fjalë duke pasur në konsideratë madhësinë e tabelës;
- Në emërtimet e rrugëve p.sh ‘Rruga kryesore Kaçanik’ duhet të hiqet fjala ‘kryesore’ sepse nuk është e nevojshme;
- Mënyra e të shkruarit të emrave duhet të jetë e njëjtë për të gjitha emërtimet.
Emrat duhet të jenë të plotë, me shkronja të mëdha p.sh. RRUGA PESHKATARI, RRUGA JUSUF GËRVALLA, RRUGA TEUTA;
- Zgjatimi i rrugës duhet të vazhdojë me emrin e rrugës ekzistuese;
- Fjalët “ i/e vjetër” dhe “i/e ri” nuk duhet të përdoren në emërtimet e ZQP;
- Nuk lejohet përdorimi i emrave me fjalë të vështira për t’u shkruar ose shqiptuar.

5.2 Konfigurimi i rrjetit rrugor

Ndarja e saktë e ZQP është shumë e rëndësishme për përcaktimin e adresave në mënyrë që sistemi i adresave të jetë i dobishëm dhe funksional.

Teknikisht duhet të fillohet me sheshin në qendër të komunës dhe rrugët

kryesore që lidhen me të, dhe më pas me rrugët kryesore dhe dytësore duke u larguar nga qendra drejt periferisë. Numrat e rrugëve kryesore në krahun e majtë dhe të djathtë nisen aty ku konstatohet fillimi i asaj rruge. Kur përfundohet identifikimi i rrugëve kryesore, shkohet në një nivel më të detajuar si rruga e rendit të dytë, e rendit të tretë e deri tek paraqitja e rrugicave. Rruga e rendit të dytë e ka fillimin në rrugën kryesore, të shkruar me numrin më të vogël në krahun e majtë dhe në krahun e djathtë. Kështu vazhdon me secilën rrugë të rangut vijues duke filluar në rrugën e rangut më të lartë. Në figurën 4 është paraqitur mënyra e konfigurimit rrugor dhe numërtimi i tyre.



Figura 4. Konfigurimi i rrjetit rrugor

Përcaktimi i ZQP-ve në lidhje me gjatësinë, funksionin e tyre dhe komunikimi i rrjedhshëm i ZQP-ve nga njëra tek tjetra është thelbësore për një adresim të logjikshëm dhe të lehtë për t'u kuptuar. ZQP-të që gjeometrikisht janë segmente të drejta dhe të gjata nëse copëtohen për të krijuar disa ZQP të shkurtra, duhet të jetë plotësisht e nevojshme për të ndërmarrë një ndarje të tillë.

ZQP-të me segmente shumë të gjata mund të bëjnë adresimin e rëndë, konfuz dhe të

vështirë për të shtuar numra të rinj në të ardhmen. ZQP që janë shumë të shkurtër dhe me numër të vogël të objekteve të adresueshme krijojnë punë shtesë për punën e vendosjes dhe mirëmbajtjes së tabelave.

Kur të gjykohet se një ZQP duhet të ketë emrin dhe llojin e vet përgjatë gjithë gjatësisë së saj, faktorët e më poshtëm duhet të merren parasysh:

- gjatësia e ZQP-së,
- numri i hyrjeve në objektet e adresueshme të lidhura me ZQP,
- preferohet më shumë se 10 (dhjetë) adresa në zonat urbane të populluara,
- dalja e ZQP dytësore në ZQP kryesore,
- si rrugë lidhëse midis dy ZQP-ve,
- zgjatimi dhe zgjerimi i ZQP-së në të ardhmen,
- forma gjeometrike e ZQP-së,
- shërben dhe lehtëson komunikacionin për të arritur tek bizneset dhe
- zhvillimet urbanistike në të ardhmen

Në figurën 5 më poshtë është paraqitur një skemë e rrjetit të ZQP ku përcaktimi i secilës ZQP dallohet qartë përmes ngjyrës dhe shkronjës së veçantë.




Figura 5. Përcaktimi i ZQP-ve në bazë të ngjyrës dhe emrit

5.3 Fillimi dhe mbarimi i ZQP

Çdo ZQP duhet të ketë një fillim dhe mbarim. Aplikacioni SIRA do të lejojë përdorimin e simboleve të duhura që puna të lehtësohet gjatë procesit të numërimit dhe të kontrollit. Në fund të procesit numri i simboleve të fillimit të ZQP duhet të jetë i barabartë me numrin e simboleve të mbarimit të ZQP.

Nëse fillimi i rrugës (vendosja e shigjetës së gjelbër) vendoset jo korrekt atëherë rrjedhimisht do të ndikojë negativisht në numërtimin e objekteve të adresueshme, për shkak se aplikacioni do të bëjë numërtimin automatikisht duke u bazuar në fillimin e rrugës. Në figurat 6 dhe 7 janë sqaruar dy raste të adresave të kombinuara rrugë - bulevard.

Bulevardet apo rrugët kryesore që ndërpriten me sheshin në qendrën e komunës e kanë fillimin e tyre në kryqëzimin me sheshin.




Figura 6. Fillimi dhe mbarimi i ZQP-ve

The diagram shows a four-way intersection. The horizontal road is labeled "Bulevard 'Bajram Curri'" at the top. The vertical road is labeled "Rr: 'Sami Frasheri'" on both sides. The intersection is marked with a red 'X' in the center. Four green arrows indicate the flow of traffic: one pointing down from the top, one pointing up from the bottom, one pointing left from the right, and one pointing right from the left. In the top-right quadrant, there is a text box that says "Fillimi i rruges kur nderpritet me BLVD" with an arrow pointing to the intersection. In the bottom-left quadrant, there is a text box that says "Mbarimi rruges" with an arrow pointing to the intersection. In the bottom-right quadrant, there is a text box that says "Fillimi i rruges (L-P)" with an arrow pointing to the intersection. On the left side of the intersection, there is a red arrow pointing left with the text "Rr: 'Abdyl Frasheri'" next to it. On the right side of the intersection, there is a green arrow pointing right with the text "Rr: 'Abdyl Frasheri'" next to it.

17

kryesisht rrugë pa krye e kanë fillimin e tyre në kryqëzimin me rrugën kryesore ku ato kanë daljen. Në rastet kur ZQP ka formën e një harku të mbyllur, fillimi i saj është tek kryqëzimi me rrugën tjetër dhe drejtimin lindje – perëndim.

5.4 Prioriteti i ZQP

Përcaktimi i pikënisjes së adresimit lidhet ngushtë me prioritetin e ZQP. Zona e parë se nga ku do të fillojë numërimi është qendra e komunës dhe duke u drejtuar nga qendra drejt periferisë. Prioritet të lartë kanë sheshi kryesor në qendrën e komunës, bulevardet, dhe me pas vijnë rrugët kryesore (arteriale) që lidhin zona të mëdha banimi, rrugët dytësore dhe rrugët lokale.

Nëse janë identifikuar saktë prioritetet e ZQP brenda Komunës, si rrjedhojë numërimi kryhet fillimisht për ZQP me prioritet të lartë duke vazhduar deri tek ZQP me prioritet të ulët. Në figurën 8 janë paraqitur prioritetet gjatë formimit të sistemit të adresave.

Objektet në sheshe, bulevarde dhe rrugë kryesore numërtohen në fillim dhe pastaj fillon numërimi i objekteve në rrugët dytësore dhe rrugicat.




Figura 8. Prioriteti i adresimit të ZQP-ve

5.5 Kodi dhe segmentet e ZQP

Para se të bëjë emërtimin e ZQP-ve, komuna përcakton një kod për çdo ZQP. Ky kod do të jetë unik ashtu si edhe emri i ZQP. Nëse RRUGA LIPJAN përbëhet nga 10 segmente atëherë të gjitha segmentet që përbëjnë këtë rrugë do të marrin një kod unik si p.sh kodi 27 i përcaktuar në bazë të emrit. Figura 9 prezanton kodin e rrugës e cila është e ndarë në disa segmente. Ky është një kontrollë, sepse kodi i rrugëve është njëkohësisht kontrollë për numrin e rrugëve të cilat duhet të jenë të barabarta.




Figura 9. Kodi dhe segmentet e ZQP-ve

Numri total i emrave duhet të jetë i barabartë me numrin total të kodeve. Komuna A ka aprovuar 466 emra ZQP kështu që numri i kodeve duhet të jetë 466. Nëse emrat ekzistues kanë tashmë kodin e tyre, atëherë duhet pasur kujdes që kodi ekzistues të mos përdoret përsëri për emrat e rinj. Të listohen kodet nga numri më i vogël drejt numrit më të madh për të dalluar cilët numra mungojnë nga lista që mund të përdoren për emrat e rinj dhe të vazhdojnë me numrat pasardhës. Nëse në të ardhmen ndryshon emri i ZQP-së, kodi i saj ruhet dhe mbetet i njëjtë. Kodi dhe emri i ZQP-së në lidhje me komunën ku ndodhet ZQP është unik në nivel shteti.




Figura 10. Vargu i adresave për një segment

Në skemën më sipër jepet vargu i adresave për segmentin 8 – krahu i djathtë i Rrugës Lipjan. Çdo segment i ZQP-së ka vargun e saj të adresave. Sa herë që krijohet një rrugë e re që ndërpritet me rrugën ekzistuese segmentet do të pësojnë ndryshime rrjedhimisht edhe vargu i adresave ndryshon.

5.6 Kalimi ZQP nëpër disa njësi administrative

Gjatë procesit të emërimit do të ketë raste kur një apo më shumë ZQP kalojnë nëpër disa vendbanime brenda një komune apo përshkon kufijtë e disa komunave.



Figura 11. Kalimi i ZQP nëpër disa komuna

Rregulli kryesor është që emri i ZQP-së që kalon nëpër disa njësi administrative do të jetë i njëjtë dhe komunat e përfshira duhet të fillojnë bashkëpunimin e tyre që në fazën e emërimit.

Është e rëndësishme që fillimisht të identifikohen ZQP-të që kalojnë brenda disa vendbanimeve brenda vetë komunës dhe më pas të konstatohet nëse komuna ka ZQP që pjesërisht kalon edhe tek komuna fqinje. Numri i ZQP-ve të përbashkëta për disa komuna zakonisht është i ulët. Raste të tilla mund të jenë rrugët nacionale që lidhin qytetet midis tyre.

Kur emrat e të gjitha ZQP-ve që ndodhen plotësisht brenda kufirit të komunës janë përcaktuar, atëherë duhet të kontaktohet ZPU të komunës fqinje për të diskutuar dhe vendosur për emërtimin e kësaj ZQP-je dhe se cila nga komunat do të fillojë numërtimin e para. Në këtë diskutim është me rëndësi që komunat përfshirëse të vijnë të përgatitura me informacionin hartografik të nevojshëm në lidhje me segmentet dhe numrin e objekteve të adresueshme që kanë dalje në këtë ZQP brenda territorit të secilës komunë.

Secila komunë duhet të japë disa alternativa për emrin e kësaj ZQP dhe të zgjidhet me mirëkuptim emri që i përshtatet më mirë situatës dhe kodi unik i saj. Pas përcaktimit të kodit të ZQP-së, duhet të diskutohet se cila prej komunave fillon e para adresimin. Për këtë qëllim duhet të konsultohet informacioni që paraqitet në hartë dhe të përcaktohet pikënisja e kësaj ZQP dhe cila komunë do të fillojë dhe mbarojë numërtimin. Pas marrëveshjes së bërë midis komunave përfshirëse fillon adresimi i koordinuar midis tyre në mënyrë që numërimi të jetë i logjikshëm dhe i qartë.

Si rregull, adresimi bazohet në parimin rendor progresiv, prandaj për parcelat kadastrale të lira rezervohet adresë rezervë në një distancë prej 10 metrash, duke matur distancën në gjithë ZQP brenda komunës e cila fillon e para numërtimin. Duhet të lihen numra rezervë edhe pse nuk ka objekte ekzistuese në mënyrë që të akomodohen ndërtimet e reja dhe të mos vështirësohet procesi i adresimit në tërësi.

Komuna që fillon e para bënë të ditur adresën e fundit që ka caktuar për ZQP e përbashkët të komunës tjetër në mënyrë që komuna fqinje të fillojë numërimin e pjesës tjetër të ZQP.

Komuna e dytë në radhë për adresim e fillon numërimin aty ku e ka lënë komuna e parë e kështu me radhë nëse ka komuna të tjera të përfshira në këtë proces.




Figura 12. Emërtimi i ZQP-së e cila kalon nëpër dy komuna

Në rastet kur një ZQP e tërë apo një pjesë e saj shërben si kufi midis dy komunave, komunat përcaktojnë edhe në këtë rast drejtimin e numërimit. Numërtimi duhet të jetë i koordinuar midis dy komunave që të shmangen numrat çift (tek) në të dyja anët e rrugës.

Rekomandohet që komuna që ka më shumë objekte në krahun e saj, të fillojë e para në mënyrë që numrat të korrespondojnë përballë njëra-tjetrës.

Edhe në raste të tilla caktohen numra rezervë dhe lejohet kombinim i numërimit klasik dhe metrik.

Por nëse shihet e arsyeshme dhe e rregullt mund të ndryshohet emri i ZQP në kryqëzim në mënyrë që të mos rëndohet numërtimi dhe të vështirësohet gjetja e objekteve.

6. Numërtimi

6.1 Parimet kryesore

Për të pasur një adresim të saktë dhe qartësi në regjistrimin e çdo adrese, numërtimi duhet të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin për Sistemin e Adresave dhe Udhëzimet Administrative. Më poshtë jepen të përmbledhura disa nga parimet kryesore:

- Adresat janë unike brenda territorit të çdo komune.
- Numri mund të caktohet vetëm brenda emërimit zyrtar të çdo pjese të ZQP - së.
- Përcaktimi i saktë i hyrjes në objekt dhe ZQP-së përkatëse është i domosdoshëm para nisjes së numërimit.
- Numërtimi kryhet duke pasur parasysh jo vetëm pikënisjen e ZQP, por edhe konfigurimin, prioritetin dhe klasifikimin e tyre.
- Numërtimi fillon dhe mbaron në krahun e ZQP-së që ka më shumë objekte. Posa që të themelohet sistemi i adresave të gjithë numrat e adresave në çdo rrugë (ZQP) duhet të caktohen në mënyrë vazhduese dhe të jenë unike.
- Vendimi për caktimin e numrave të adresave duhet të regjistrohet në hartë për të përcaktuar lokacionin e saktë gjeografik të pikës së adresës (objektit të adresueshëm). Harta me numra të adresave quhet plan vendosje.
- Në rast se vendimi i takon disa kateve dhe nëse vendndodhja nuk paraqitet qartësisht nga fotografia ajrore, atëherë skica ballore shtohet për qartësi.
- Në rastet kur kemi ndryshim të emrit të ZQP –së , ose shtesë anësore të ndërtesës apo ngritje kati mundet që pjesa më e madhe e adresave të objekteve të banimit mbetet e pandryshuar, ndërsa objektit të ri të banimit mund t'i caktohet një adresë e re që përshtatet me adresat ekzistuese.

6.2 Përcaktimi i vendndodhjes së hyrjes në objekt

Gjatë procesit të numërimit fillimisht përcaktohet vendndodhja e objekteve, dhe kontrollohet nëse të gjitha ndërtesat që janë në terren janë edhe në hartë. Para fillimit të procesit duhet të vërtetojmë dhe të jemi të sigurt që të gjitha

ndërtesat e reja, apo edhe ato objekte që kanë pësuar ndryshime të pasqyrohen në hartë, siç janë paraqitur objektet me ngjyrë të verdhë më poshtë, në mënyrë që çdo objekt të adresohet. Figura 13 paraqet evidentimin e objekteve në terren të cilat në hartë nuk gjenden por janë paraqitur me ngjyrë të verdhë në mënyrë që të marrin adresën e vet.



Figura 13. Evidentimi i objekteve në terren të cilat nuk gjenden në hartë

Për të lehtësuar procesin e numërtimit është e këshillueshme që të bëhet jo vetëm përcaktimi i hyrjes në objekt por edhe i kufijve përfaqësojës që kanë dalje tek çdo ZQP. Në hartë vizatohet një kufi imagjinar me dorë të lirë rreth e qark hyrjeve që kanë dalje në këtë ZQP të cilat do të marrin adresën e kësaj ZQP.



Figura 14. Evidentimi i hyrjeve që kanë dalje në një ZQP

Hyrjet e objekteve në bulevardet dhe rrugët kryesore (arteriale) numërohen në fillim dhe pastaj fillon numërimi i rrugëve dytësore dhe në fund rrugët me një dalje.

Për ta ilustruar me shembull këtë proces, figura 15 paraqet shenjëzimin e hyrjeve që kanë dalje në një ZQP, ku objektet brenda poligonit të kuq janë shënuar me inicialet e emrit të ZQP-së që i takon edhe adresa. Për ta thjeshtësuar këtë, shkronjat HP janë përdorur për emrin e rrugës Hasan Prishtina, AJ për Rruga Adem Jashari, IB për Rruga Isa Boletini.



Figura 15. Shenjëzimi i hyrjeve që kanë dalje në një ZQP

6.3 Drejtimi i numërtimit

Bëhet përcaktimi i pikënisjes dhe mbarimit të ZQP-së (bulevardit, autostradës, sheshit, parkut, rrugës, rrugës me një dalje) me simbolet përkatëse. Pikënisja përcakton edhe drejtimin e numërtimit. Në fillim të secilës ZQP, pranë simbolit të pikënisjes rrjedhimisht numrat e adresave janë numra të vegjël 1, 3, 5, 7 ndërsa drejt fundit të ZQP, pranë simbolit të mbarimit të rrugës numrat e adresave janë numra të mëdhenj 137, 139, 141 apo edhe me katër shifra 1037.

6.4 Numrat e adresave çift dhe tek

Pasi është përcaktuar drejtimi i çdo ZQP, duhet të pozicionoheni në fillim të çdo ZQP - dhe fillohet procesi i numërtimit. Numërtimi rendor i objekteve fillon me numrin më të vogël çift apo tek në varësi të krahut të rrugës.

Numri i adresës për çdo ZQP varet edhe nga numri i hyrjeve në objekte dhe gjatësia e rrugës. Mund të kemi raste kur adresat mund të shkojnë nga 1 deri 1237 i cili është një tregues i numrit të lartë të hyrjeve në objekte dhe llojit të ZQP i cili mund të jetë bulevard apo rrugë kryesore.

Hyrjeve në objekte që ndodhen në anën e majtë të ZQP, u vendosim numra tek 1, 3, 5, 7, 9 ...135...1131.. 2217., ndërsa atyre në krahun e djathtë numra çift 2, 4, 6, 8 ..148.....1244....2218 e kështu me radhë deri në fund të ZQP siç është paraqitur në figurën 16;




Figura 16. Numrat e adresave çift dhe tek

Rregulli i numrave çift/tek dhe pozicionimi ynë në fillim të ZQP-së nuk duhet të aplikohet vetëm kur kemi objekte në të dyja anët e ZQP por edhe në ato raste kur objektet e adresueshme ndodhen vetëm në një anë të ZQP, apo edhe kur ndërtesat nuk ndodhen pranë rrugës.




Figura 17. Numrat e adresave kur objektet e adresushme ndodhen vetëm në njërën anë të ZQP

6.5 Hyrja në objekt

Çdo hyrje/dalje kryesore në objekt paraqitet vetëm me një pikë (simbol) dhe çdo gjurmë objekti ka vetëm një të tillë (ndërtesë individuale) apo disa (ndërtesë kolektive me funksion të përzier): këto hyrje/dalje do të përcaktojnë edhe adresën e objektit pra nëse i takon një rruge apo një tjetre.

Një ndërtesë banimi, për shembull ka 4 (katër) hyrje për banorët dhe 12 njësi tregtare, atëherë në total duhet të vendosen 16 pika për këtë gjurmë objekti dhe rrjedhimisht të caktohen 16 adresa.

Për përcaktimin e vendndodhjes së hyrjeve është i nevojshëm verifikimi në terren por meqenëse urbanistët e njohin shumë mirë zonën e tyre një pjesë e punës mund të bëhet fillimisht në zyrë dhe të identifikohen zonat që kërkohet informacion shtesë. Është e nevojshme përgatitja e materialeve dhe hartave për grupet e punës që do të kryejnë verifikimin e objekteve në terren.

Çdo hyrje/dalje në një objekt të adresueshëm (banimi, biznesi, etj.) do të ketë një numër unik të adresës dhe nëse ka më shumë se një banesë/zyre një objekti do t'i përcaktohet numër individual për çdo njësi të tillë (banesë/zyre). Këta numra rendor të brendshëm të njësive brenda objektit së bashku me numrin e adresës në lidhje me ZQP përbëjnë adresën e plotë të banorit.

Në qoftë se një objekt ka dy apo me shumë hyrje, hyrje e parë quhet ajo që ndodhet në krah të majtë nëse qëndrojmë me fytyrë nga ndërtesa në drejtim të hyrjes/hyrjeve në këtë ndërtesë. Drejtimi i numërtimit përcakton edhe radhën e tyre.




Figura 18. Ndërtesë banimi me dy hyrje

Nëse një objekt i adresuar më parë ndahet në mes nga pronari (për arsye vetanake) dhe secila prej këtyre hyrjeve ka portën e saj të veçantë ose gardh/mur rrethues midis tyre do të konsiderohen si dy objekte dhe marrin 2 (dy) numra adresash individuale. Secila portë do të ketë numrin e saj të adresës dhe ndryshimet që ka pësuar ky objekt duhet të pasqyrohet edhe në hartë. Pra, në hartë nuk do të jetë vetëm një gjurmë të objektit por do të jenë dy gjurmë që reflektojnë ndryshimin.




Figura 19. Adresimi i objektit i cili është ndarë në dy pjesë

Objektet janë me forma të ndryshme dhe me hyrje në një apo në disa krahë. Në rastet kur jo të gjitha hyrjet ndodhen në një krah të objektit, por janë në krahë të ndryshëm, fillimisht numërtohen në mënyrë progresive hyrjet që janë përballë rrugës dhe pastaj ato mbrapa objektit. Numërtimi i hyrjeve të objektit, në rastet kur jo të gjitha hyrjet ndodhen në një krah të objektit janë paraqitur në figurën 20. Kjo formë do të ishte më e preferuara për rastet e tilla.




Figura 20. Numërtimi i hyrjeve në rastet kur jo të gjitha hyrjet ndodhen në një krah të objektit

6.6 Numrat rezervë

Gjatë adresimit për herë të parë duhet të parashikohen numra rezervë për trojet (parcelat kadastrale të lira) midis objekteve ekzistuese, apo në zona të reja banimi ku janë parashikuar ndërtime të reja për të ardhmen, siç janë paraqitur me shigjeta në figurat e mëposhtme. Në parcelat kadastrale që janë të lira si në figurën 21, parashihet që të ketë ndërtime të reja, sepse ajo pjesë kryesisht është tokë ndërtimore.



Figura 21. Parcelat kadastrale të lira

Objektet e reja, që ngrihen pas përfundimit të numërimit, do të adresohen sipas rregullave të përcaktuara në Ligj për Sistemin e Adresave dhe në Udhëzimet Administrative. Objekteve të reja u vihen numrat që u janë lënë rezervë trojeve (parcelave kadastrale të lira), ku janë ngritur ndërtesat.

Në rastet kur nuk ekziston një dendësi konstante e objekteve në radhë njëra pas tjetrës mund të bëhet një kombinim i numërimit rendor progresiv dhe atij metrik. Për shembull, në krahun e djathtë të Rrugës Dardania prej fillimit deri tek mesi i gjatësisë së saj objektet janë të radhitura në varg uniform, por nga mesi i ZQP e

drejt fundit të saj ndodhen parcela kadastrale të lira (PKL) dhe vetëm në fund të rrugës ndodhet një numër i kufizuar objektesh. Në këtë rast numërtimi fillon normalisht duke numëruar çdo objekt me numër çift (me hap 2) deri tek objekti i fundit para PKL (2 – 110), shih figurën 22. Për të llogaritur numrin e objektit pas PKL duhet të matet distanca e PKL nga fillimi deri tek fundi i saj.

Në zonat urbane, në varësi të distancës llogaritet një numër adrese për çdo 10 m gjatësi rruge.

Nëse distanca është 500 m atëherë do të ruajmë 25 numra rezervë. Në këtë mënyrë llogarisim që numri i adresës për objektin pas PKL është 160. Rrjedhimisht, objekte të reja që mund të ngrihen në të ardhmen akomodohen krejt lehtësisht kur janë parashikuar numra rezervë të mjaftueshëm.




Figura 22. Numrat rezervë për parcelat kadastrale të lira

Lënia e numrave rezervë për zonat urbane/rurale në zhvillim e sipër e bënë numërtimin e logjikshëm dhe mundëson aplikimin e parimit të adresave korrespondense çift/tek gjë që lehtëson gjetjen e tyre nga çdokush në një kohë shumë të shkurtër por duke pasur parasysh këtu edhe shërbimin e shpejtë në rast urgjence.




Figura 23. Numrat rezervë për trojet (parcelat) e lira

Më poshtë është ilustruar me vijë të kuqe një zonë ku duhet të lihen numra rezervë. Numrat rezervë në këtë rast duhet të jenë prej numrit 24 deri 38, por mund të ndodhë që këta numra rezervë të mos përdoren sepse zona e paraqitur në figurë është klasifikuar zonë e gjelbër. Ndërtesat që mund të ndërtohen pas kësaj zone në vazhdimësi të ZQP nuk mund të përdorin numrat 24 deri 38 edhe pse janë rezervë (shih pikën 4.12 Korrespondimi midis numrave).



Figura 24. Hapësirë e lirë e cila nuk është e dedikuar për ndërtim

6.7 Adresa me numër dhe shkronjë


Sipas Udhëzimit Administrativ 14/2019 neni 15, adresa mund të përmbajë një numër dhe një shkronjë shtesë (p.sh 15A) në mënyrë që të shmangim ri-numërimin e adresave të caktuara më parë. Kjo do të jetë e përdorshme në ato raste kur një objekt ekzistues me adresë pëson ndryshime si p.sh ndarje të sipërfaqes së objektit /njësisë së mëparshme.

Duhet pasur parasysh që gjatë adresimit për herë të parë nuk duhet të përdoren shkronjat për adresat meqenëse kemi numra të mjaftueshëm në dispozicion. Në të ardhmen kur të lind nevoja mund të përdoren shkronja, por duhet pasur kujdes që të gjitha adresat që do të pësojnë ndryshime duhet të kenë të njëjtin numër dhe t'i shtohet një shkronjë nga A deri tek Z në drejtimin e numërimit.

Shkronjat duhet të jenë shkronja të mëdha të alfabetit dhe nuk duhet të ketë hapësirë mes numrit dhe shkronjës.

Shkronjat I, O, Q dhe shkronjat DH, TH, SH, ZH, XH, NJ nuk duhet të përdoren. Në shembullin më poshtë është dhënë situata e adresimit para dhe pas ndryshimit të bërë në objekt që shihet edhe në figurën 25.

Gjendja e adresimit për herë të parë:



Gjendja pas ndryshimit:




Figura 25. Situata e adresimit para dhe pas ndryshimit të bërë në objekt

6.8 Numri i adresës me numër dhe fraksion

Sipas Udhëzimit Administrativ 14/2019 nenit 15 pikës 1.18 lejohet vendosja e numrave të adresave me fraksion por duhet pasur parasysh që të përdoren me

kujdes vetëm pas përfundimit të adresimit të territorit për herë të parë. Numrat me fraksion do të përdoren vetëm në ato raste kur nuk ka zgjidhje tjetër, në mënyrë që të parandalohet përdorimi i tepruar i tyre.

Në rastet kur një grup objektesh të reja janë ndërtuar në mes apo prapa objekteve ekzistuese dhe nuk kanë dalje drejtpërdrejt në ZQP kryesore (të emërtuar) e bën ndjekjen e rregullave dhe logjikes së numërimit të vështirë, atëherë duhet parë mundësia se si mund krijoni ZQP ku të gjitha këto ndërtesa kanë dalje dhe ta emërtoni ose të përdorni ZQP ekzistuese dhe të bazoheni tek adresa më e afërt.

Gjatë përcaktimit të adresës me fraksion merren parasysh kriteret e përgjithshme të numërimit por në veçanti duhet të merren në konsideratë:

- Vendndodhja dhe dukshmëria e objektit nga ZQP,
- Çasja në objekt nga një apo disa ZQP,
- Cila ZQP i përshtatet më mirë,
- Drejtimi i numërimit,
- Distanca pranë objekteve ekzistuese që kanë adresë dhe
- Kufizimet e trafikut

Numri me fraksion rritet në mënyrë progresive dhe duhet të jetë vetëm me një shifër. Fraksioni duhet të përmbajë vetëm numrat 1 deri në 9, p.sh. 31/9 ndërsa adresat 31/10, 135/11 nuk janë të rekomanduara.

Një objekt me numër me fraksion mund të ketë dalje në rrugë të ndryshme dhe mund të nevojiten adresa nga secila ZQP.

6.9 Kryqëzimi i rrugëve

Në një udhëkryq mund të hasim raste të ndërprerjes së 2, 3, apo 4 rrugëve me emra të ndryshëm. Në shembullin më poshtë, në figurën 26, është ilustruar rasti i ndërprerjes së 3 rrugëve me emra të ndryshëm.

Numërtimi do të jetë rendor progresiv dhe në varësi të fillimit të rrugës numrat rriten nga fillimi drejt mbarimit të rrugës. Numërtimi i objekteve në të njëjtin emër rruge vazhdon pa ndërprerje edhe pas kryqëzimit.



Figura 26. Kryqëzimi i 3 rrugëve me emra te ndryshëm

6.10 Transformimi i objekteve

Nëse dy ose me shumë objekte kanë pasur numër individual të cilat shemben dhe transformohen në një ndërtesë të vetme, ndërtesës së re i vihet numri i parë më i vogël nga i gjithë grupi i objekteve të shembura. Kjo duhet të bëhet me kujdes që numërtimi të jetë progresiv dhe në përputhje me drejtimi e ZQP.

Në këtë shembull nga numrat që kishin objektet para transformimit 120-126 zgjidhet numri 120 ndërsa numrat 122, 124, 126 mbeten numra rezervë. Rasti i paraqitur ne figurën 27 tregon mënyrën e numërimit kur disa objekte zëvendësohen me një të ri dhe me përmasa të mëdha.

Por kur objekti ndërtohet në mes dhe ka hapësira të lira në të dy anët e objektit të ri, të lihen numra rezervë në të dy anët e objektit p.sh. 120, 122 - 124 është numri i objektit të ri - dhe 126 numër rezervë.




Figura 27. Transformimi i grup shtëpive në një ndërtesë kolektive

6.11 Sheshet

Ndërtesat që kanë dalje në shesh (Fig.28) patjetër do të marrin adresën e sheshit. Në sheshe, pasi përcaktohet pika e nisjes me drejtim veriun - numrat e adresave rriten në mënyrë progresive në drejtim të akrepave të orës d.m.th. rriten nga veri-lindje në drejtim të jug-perëndimit.

Numrat e adresave mund të jenë rendor 1,2,3,4....12. Në raste të kufizuara mund të ndodhë që të kemi objekte brenda dhe jashtë sheshit (rrethit) atëherë duhet të përdoren numra çift 2,4,6, për objektet jashtë sheshit dhe numra tek 1,3,5,për brenda sheshit. Është e rëndësishme që të ruhet e njëjta logjikë për të gjitha sheshet brenda komunës.

Duhet pasur kujdes numërtimet në rastet kur ndërpritet sheshi me rrugën dhe të jetë e qartë se ku mbarojnë numërtimet e sheshit dhe fillojnë numërtimet e rrugës.

Ikja nga konfuzioni i adresave kërkon shmangien e numrave të njëjtë pranë njëra tjetrës edhe pse njëra ka adresën e rrugës dhe tjetra ka adresën e sheshit. Në rastin e adresimit të dy objekteve që ndodhen pranë njëra tjetrës me dalje në ZQP të ndryshme - konstatohet se të dyja duhet të marrin numrin 6, atëherë numri 6 do t'i jepet atij objekti që ka dalje në ZQP me prioritet më të lartë. Ky numër të mos përdoret për objektin e ZQP tjetër pranë, por të kalohet tek numri pasardhës. Ky rregull duhet të zbatohet jo vetëm për adresimin e shesheve por edhe për ZQP të tjera siç është paraqitur në figurën 28.




Figura 28. Numërtimi i shesheve

6.12 Korrespondimi i numrave të adresës

Lehtësimi i orientimit në adresën e kërkuar bëhet nëse numrat në të dy krahët e rrugës korrespondojnë d.m.th. janë me madhësi afër njëri tjetrit. Sipas Udhëzimit Administrativ 14/2019 neni 15 pika 1.20 gjatë procesit të numërtimit duhet pasur shumë kujdes që numrat çift në anën e djathtë të korrespondojnë me numrat tek në anën tjetër të rrugës. Ky numërim i tillë e lehtëson orientimin dhe gjetja e adresave bëhet tepër efikase. Në shembullin më poshtë në figurën 29, vini re adresat 69 dhe 70, 20 dhe 21 përballë njëra tjetrës dhe numrat rezervë për të akomoduar ndërtime të reja.

Ndryshimet e vazhdueshme në zhvillimin urban, kërkojnë që gjatë adresimit të parë si adresim fillestar të lihen numra rezervë të mjaftueshëm në mënyrë që adresat e objekteve që do të ndërtohen në të ardhmen të sistemojnë në mënyrë logjike.




Figura 29. Korrespondimi i numrave të adresave në të dy anët e ZQP-së

Përpjekjet duhet orientuar që gjatë numërtimit në krahun përballë numrit të adresës 100 të jetë ndërtesa 99 ose 101 dhe jo adresa 6, edhe pse nganjëherë ndodhë një gjë e tillë me ndryshime të mëdha të madhësisë së numrit në të dy krahët. Gjatë procesit të adresimit takoheni me shumë raste kur të dy krahët e rrugës nuk kanë të njëjtën dendësi objektsh, të lihen numra rezervë ose të përdorur në varësi të çdo situatë që identifikimi i adresës në terren të jetë sa më i lehtë.

6.13 Rrugët me një dalje – jo emërtim

Gjatë adresimit hasen shpesh raste të tilla kur rruga kryesore kryqëzohet me rrugë pa dalje të cilat nuk i plotësojnë kriteret për emërtim.

Në ilustrimin e mëposhtëm në figurën 30, numërtimi fillon nga pikënisja e ZQP-së kryesore dhe u jepet adresë fillimisht objekteve që i përkasin segmenteve të rrugës kryesore 1, 3, 11, 13 e njëkohësisht ndjek rrugën pa dalje, sipas vijës së kuqe të paraqitur në figurën 30, për të numërtuar të gjitha objektet nëpër rrugicat e pa-emërtuara 5, 7, 9, 16 etj. Kjo vazhdon në mënyrë progresive, pa ndërprerje numërtimin e objekteve deri në përfundim të rrugës kryesore.




Figura 30. Numërtimi i hyrjeve në rrugët me një dalje




Figura 31. Numërtimi i hyrjeve në rrugët me një dalje

6.14 ZQP në formë harku

Numërtimi në ZQP-të në formë harku si në figurën 32 dhe në figurën 33, është disi kompleks sepse fillimi dhe mbarimi takohen në një pikë, por përcaktimi korrekt i pikënisjes dhe drejtimit të numërimit e bënë atë më të thjeshtë. Më poshtë jepen dy raste tipike të ZQP-ve në formë harku. Duhet pasur kujdes që numrat e adresave edhe në këtë lloj ZQP të korrespondojnë në të dy krahët e saj.




Figura 32. Numërtimi i rrugëve në rrugët në formë harku



Figura 33. Numërtimi i rrugëve në rrugët në formë harku

6.15 Objektet me disa hyrje

Objektet me disa hyrje kanë mundësi çasje në disa rrugë kështu që krijohet edhe mundësia për të njëjtin objekt të kemi 2 e më shumë adresa për shkak të hyrjeve. Nëse një objekt i adresueshëm ka disa hyrje të njohura si pika kryesore hyrëse në objekt, në përgjithësi t'i jepet adresë secilës prej tyre, pra të gjitha hyrjet që janë pikat e hyrjes në objekt, duhet të kenë adresën e vet. Disa raste janë paraqitur në figurën 34, 35, 36 në vijim.

Më poshtë ilustrohen tri raste tipike:

1- një objekt me disa hyrje dhe me dalje në ZQP të njëjtë



Figura 34. Numërtimi i një objekti me disa hyrje dhe me dalje në ZQP të njëjtë

2- një objekt me disa hyrje dhe me dalje në dy ZQP të ndryshme.

Siç tregohet në figurën më poshtë objekti ka 2 pika hyrëse njëherë në rrugën Prizreni dhe tjetrën në Rrugën Deçan. Në këtë rast ky objekt ka një adresë – numër tek dhe një adresë - numër çift, por mund të ndodhë që të dy adresat në rrugë të ndryshme të jenë numra çift ose tek në varësi të fillimit të ZQP.

Nëse gjatë numërimit rastis që të dy adresat janë të njëjtit numër p.sh. *Rruga Deçan 2* dhe *Rruga Prizreni 2* duhet të shmangët patjetër përdorimi i të njëjtit numër. Të lejohet vetëm njëri numër për rrugën që mendoni se është më e përshtatshme për objektin dhe për numrin tjetër të zgjidhet numri pasardhës.




Figura 35. Numërtimi i një objekti me disa hyrje

3- një objekt me disa hyrje dhe dalje në katër ZQP të ndryshme.

Në këtë shembull çdo ngjyrë paraqet hyrjet në objekt dhe rrugën tek e cila ato kanë daljen. Numrat e adresave do të përcaktohen në bazë të drejtimit të numërimit për secilën rrugë. Çdo hyrje do t'i caktohet një numër adrese individuale çift ose tek në varësi të krahut të rrugës.

Numërtimi i hyrjeve që kanë dalje në rrugën FEHMI AGANI (ngjyrë të kuqe), do të bëhet nga e majta në të djathtë nëse drejtimi i numërimit është prej rrugës Dëshmorët e Marecit drejt Rrugës Azem Jashanica.




Figura 36. Numërtimi i një objekti me disa hyrje dhe dalje në katër ZQP të ndryshme

Kur një banesë mund të arrihet nga më shumë se një rrugë ose hyrje, por nuk është përcaktuar se cilës prej ZQP i takon të marrë adresën, atëherë duhet të merren parasysh disa faktorë.

Për përcaktimin e saj duhet të përgjigjeni disa pyetjeve të tilla si:

- Cila hyrje përdoret më shpesh nga pronari i këtij objekti?
- Cila hyrje është vetëm për pronarin/ familjarët dhe cila është edhe për familjarët edhe për vizitorë, ose operatorë të shërbimeve të ndryshme?
- Cila prej tyre ka çasje më të lehtë?
- A mund të çasen hyrjet me automjet nga të dy rrugët?
- Ku është pjesa ballore e objektit?
- Nëse është biznes a kanë easje këto hyrje nga klientët si dhe furnizuesit?

Figura 37. Numërtimi i objekteve të cilat kanë dalje në më shumë



6.16 Ambiente me funksione jo-banimi

Objektet të cilat katet e para i kanë të destinuara për biznes dhe me dalje në ZQP, çdo lokali apo biznesi të tillë i vihet një adresë me numër rendor të veçantë. Nëse këto lokale kanë më tepër se një hyrje, secilës prej tyre i vihet një adresë individuale.

Zakonisht këto ambiente kanë pjesën ballore prej xhami me qëllim reklamimi, por materiali i xhamit e bën vendosjen e tabelave disi të vështirë. Tabelat e numrave duhet të vendosen patjetër edhe në këto lloj ambientesh; ose në shtylla (ndarëse), mbi derën/portën ose në pamundësi të përdoret material ngjitës në xham. Kjo formë e numërimit të lokaleve dhe bizneseve shihet qartë në figurën 38. Tabelat nuk duhet të vendosen asnjëherë në vende të pasigurta.




Figura 38. Numërtimi i lokaleve - bizneseve

6.17 Objekte brenda një muri rrethues

Objektet që ndodhen brenda një muri rrethues dhe kanë një dalje të përbashkët në ZQP, u vihet një numër rendor adrese individuale siç shihet në figurën 39.

Sipas drejtimit të numërimit, objektet që ndodhen jashtë murit rrethues marrin numrin paraardhës 49 ose pasardhës 57. Kjo është e aplikueshme edhe në zonat rurale.

Kjo vlenë edhe për zonat rurale për shtëpi të ulëta kur ato ndodhen brenda një oborri të përbashkët, apo për një grup spitalesh, objekte në një kompleks universiteti, kompleks vilash brenda një muri rrethues, etj.




Figura 39. Numërtimi i objekteve brenda një muri rrethues

Edhe në fazën e vendosjes së tabelave, çdo objekti do t'i vihet tabelë me numrin e adresës përkatëse brenda murit rrethues dhe gjithashtu një tabelë kolektive vendosur në mur tek hyrja kryesore si psh. 51-55 që tregon se objektet me këto adresa ndodhen brenda.

6.18 Rrugët me një dalje - me emër më vete

Rrugët me një dalje që i përmbushin kriteret e emërimit emërtohen me një emër të veçantë. Ashtu si për llojet e tjera të ZQP edhe këto rrugë kanë dy anë – anën e majtë edhe anën e djathtë dhe ndiqen me përpikëri rregullat e përgjithshme të numërimit. Fillimi i tyre është gjithmonë tek kryqëzimi me rrugën tjetër.

Shembulli i paraqitur në figurën 40, ilustron qartë nëpërmjet ngjyrave të ndryshme se si ndahen objektet për secilën rrugë ku ato kanë daljen.

Gjatë numërimit të imagjinohet që aksi i rrugës me një dalje vazhdon drejt për të përcaktuar krahun e majtë/djathtë për objektet e fundit. Numrat rezervë janë të aplikueshëm edhe në rrugë të tilla. Te objektet me një dalje gjithmonë është më lehtë të përcaktohet adresa dhe numërtimi i objekteve. Kjo është paraqitur mjaft mirë në figurën 40 dhe në figurën 41.




Figura 40. Emërtimi i ZQP me një dalje dhe numërtimi i hyrjeve në këto rrugë



Figura 41. Emërtimi i ZQP me një dalje dhe numërtimi i hyrjeve në këto rrugë

6.19 Ndërtesat e grupuara

Ndërtesat e grupuara mund të jenë në grupime të rregullta apo jo të rregullta. Grupet e objekteve të rregullta numërohen në hyrje duke e përdorur orientimin e njëjtë nga e majta në të djathtë apo e kundërta. Kur gjatë numërimit shohim raste të tilla si: grup objekteve (brenda rathëve) që ndodhen prapa njëri tjetrit (paralel ose horizontal) duhet të jetë e qartë pika hyrëse në objekt, shih figurën 42, komunikimi me rrugën ku ka dalje, dhe drejtimi i numërimit për të përcaktuar korrekt adresat e tyre.




Figura 42. . Numërtimi i grup objekteve te cilat gjenden njëri pas tjetrit

6.20 Qendër tregtare/biznesi

Qendrat tregtare mund të jenë të llojeve dhe madhësive të ndryshme. Një qendër biznesi mund të jetë një objekt i vetëm me një hyrje kryesore në rrugë për klientët dhe një hyrje anësore që përdoret vetëm nga punonjësit për furnizimin e brendshëm dhe dërgesat. Brenda objektit ka një numër të konsiderueshëm dyqanesh. Në këtë rast do t'i caktohet një numër adrese objektit dhe i bëhet numërtim i brendshëm individual çdo njësie brenda tij.

Nëse qendra është disa katëshe shpesh numri i njësive brenda saj është i madh dhe duhet pasur parasysh që njësitë në katin e parë të fillojnë me 100 (101,102...122) dhe për katin e dytë me 200 e për katin e tretë me 300 e kështu me radhë për të lehtësuar gjetjen e tyre.




Figura 43. Numërtimi i një qendre tregtare me një hyrje

Në rastin kur kemi një qendër tregtare dhe çdo njësi tregtare ka dalje në rrugë, përveç emrit identifikues të qendrës - Qendra Liria, do të jepen numra adresash individuale për çdo njësi brenda saj.

Edhe për këtë rast mund të lini numra rezervë për t'i përdorur pas ndryshimeve që mund të pësojnë hapësirat e tyre. Numrat rezervë janë gati të përdoren sa herë që objektet pësojnë ndryshime dhe numërtimi është përherë i rregullt.




Figura 44. Numërtimi i një qendre tregtare me shumë lokale dhe hyrje

6.21 Numërtimi i banesave/zyrave

Në objektet me një apo disa hyrje që kanë më shumë se sa një njësi të brendshme (banesë/zyrë) të çashtme prej saj, të gjitha njësitë numërohen në një numër të veçantë.

Numri i njësisë është numri vartës i adresës kryesore p.sh. Rruga Fehmi Agani

93 Banesa 7 - nënkupton që adresa e objektit është 93 dhe numri i banesës brenda objektit është numri 7. Numri i njësisë 7 apo nën-adresa është gjithmonë i lidhur me numrin e adresës 93 (shih figurën 45).




Figura 45. Numërtimi i banesave dhe zyrave

Në shembullin më poshtë (figura 46) është ilustruar një kat në një ndërtesë banimi apo biznesi. Ky është kati i parë i një hyrjeje në ndërtesë dhe numërtimi fillon nga e majta në të djathtë duke qëndruar me fytyrë përballë hyrjes në kat. Numrat e banesave/zyrave vijnë duke u rritur në mënyrë progresive nga katet e ulëta drejt kateve më lartë.




Figura 46. Numërtimi i banesave dhe zyrave brenda një kati

6.22 ZQP që kalon nëpër disa komuna

Siç është shpjeguar më sipër në rastin kur ZQP kalon nëpër disa vendbanime brenda territorit të një komune, do të veprohet njësoj edhe për rastet kur emri i rrugës kalon nëpër disa komuna.

Sikurse tek emërtimi i rrugëve, po ashtu edhe tek numërtimi i objekteve, komunat duhet të bashkëpunojnë në këto raste.

Komuna A fillon e para numërtimin për rrugën Egnatia dhe komuna B e fillon numërtimin aty ku e ka lënë komuna B duke ndjekur të njëjtin drejtim dhe krahun e ZQP.




Figura 47. Numërtimi i objekteve në rrugët të cilat kalojnë nëpër disa komuna

Numrat e adresave 1 deri 511 (krahu i majtë) dhe 2 deri 512 (krahu i djathtë) të rrugës Egnatia i takojnë komunës A, ndërsa komunës B i takojnë adresat 513 deri 1421 dhe 514 deri 1420 të rrugës Egnatia (shih figurën 47).

Është situatë e papranueshme kur të dyja komunat fillojnë numërtimin nga pikënisje të ndryshme pa u konsultuar me njëra tjetrën dhe një objekti i caktohen dy adresa.

6.23 Zonat rurale

Banorët e zonave rurale kanë qenë kaherë në pozitë të pafavorshme, duke mos pasur një adresë të përcaktuar qartë. Pavarësisht nga përfitimet e të pasurit një adresë që është përmendur në hyrjen e këtij doracaku, një nga arsyet pse adresimi rural ka një përparësi është se shërbimet emergjente dhe operatorët e ndryshëm, nëse është e nevojshme mund të gjejnë pronën tuaj në mënyrë më efikase.

Adresimi rural është një instrument i thjeshtë dhe i dobishëm për identifikimin, dhe gjetjen e adresave por edhe për mirëmbajtjen e regjistrit të pronave në zonat rurale.

Si funksionon numërtimi në zonat rurale?

Referuar Udhëzimit Administrativ nr. 14/2019 neni 15 pika 1.21 - numrat e adresës rurale do të përcaktohen në bazë të distancës së objektit nga fillimi i ZQP; edhe për zonat rurale do të aplikohet i njëjti rregull - numrat tek në anën e majtë të ZQP, numrat çift në anën e djathtë.

Nëse numri i adresës së përcaktuar është 597 atëherë i referohet një objekti të adresueshëm në të majtë dhe në një largësi 5.97km nga fillimi i rrugës, shih shembullin më poshtë në figurën 48.

Pikënisja për numërtim edhe në zonën rurale është qendra e fshatit, edhe në rastet kur nuk ka një të tillë, përcaktohet një qendër me qëllim të adresimit. Fillimi i ZQP dhe drejtimi i numërimit përcaktohet në të njëjtën mënyrë si për zonat urbane – në kryqëzimin me një ZQP tjetër ose nga qendra e fshatit duke u larguar drejt zonave më të largëta.

Për ZQP që ka rrugëkalim nga të dyja anët të kihet parasysh fillimi nga qendra, prioriteti i ZQP dhe më pas që numërtimi vazhdon në drejtimin jug-veri apo lindje-perëndim. Për ZQP me një dalje numërimi gjithmonë do të fillojë në kryqëzimin “T” apo kryqëzimin me rrugën kryesore/fqinjë.

Në zonat rurale, zakonisht objektet janë larg nga njëra tjetra dhe mund të ndodhë që në një rrugë me një dalje me gjatësi 2.5 km të ndodhen vetëm dy objekte. Në këto raste për vendimin nëse duhet të marrë ose jo emër më vete duhet të vlerësohet gjatësia e rrugës dhe jo numri i objekteve.




Figura 48. Numërtimi i objekteve në zonat rurale




Figura 49. Numërtimi i objekteve në zonat me dendësi të vogël të shtëpive

6.24 Organizimi i punës në grupe

Për të përshpejtuar procesin e numërtimit në rastet kur territori i komunës është i madh dhe ka disa vendbanime, mund të organizohen disa grupe pune dhe të ndahen sipas zonave. Është e rëndësishme që numërtimin e objekteve ta fillojë grupi që ka qendrën e komunës, dhe pas përfundimit të këtij procesi nga të gjithë, të përditësojnë punën e bërë së bashku në një hartë të vetme. Gjatë punës përgatitore para fillimit të procesit të numërimit, në hartë përcaktohen zonat dhe pjesët e rrugëve që i takojnë çdo grupi pune.

7. Mirëmbajtja e sistemit të adresave

7.1 Caktimi i adresës së re

Mirëmbajtja e sistemit të adresave bëhet në vazhdimësi duke e përditësuar atë me të dhëna të reja sipas kërkesave, sipas vendimeve të plotfuqishme apo sipas planeve urbanistike. Kur bëhet një kërkesë për dhënien e një adrese, duhet të merret vendndodhja e objektit/pronës, së bashku me elementet identifikuese rreth e qark tij apo pika interesi që mund të ndihmojnë për të gjetur objektin/pronën e re së cilës i duhet dhënë adresa.

ZPU është e obliguar që së paku një herë në vit të bëjë përditësimin e të dhënave në këtë formë:

1. Të rishikohet informacioni mbi adresat ekzistuese dhe indeksi i rrugëve, për të parë nëse adresa e re do të ndikojë në renditjen e numrave të adresave në segmentet përbërëse të ZQP, apo për të parë nëse kjo është një ZQP e re. Rënditja e adresave duhet të kontrollohet midis kryqëzimeve, por gjithashtu edhe prej fillimit deri në mbarimin e ZQP.
2. Kërkesa për adresë të re duhet të punohet brenda një jave nga dita e marrjes së kërkesës në dorëzim sepse banorët kanë të drejtën e shërbimeve të ndryshme si në rastet kur ata duhet të presin për adresën e banesës para se të mund të marrin shërbimin e telefonisë.
3. Pajisjet matëse (GPS) ose matje digjitale në SIRA duhet të përdoren

për të ndihmuar në përcaktimin e saktë të adresës në zonat rurale.

4. Përcaktohet adresa dhe njoftohet banori/biznesi për adresën e re. Shih Aneksin A, shembull i një letre informimi për adresën e re të drejtuar qytetarëve.
5. Një kopje e njoftimit lidhur me adresën e re u dërgohet drejtorive, subjekteve apo institucioneve të interesuara.

7.2 Ndryshimi i adresës të re

Përditësimi i sistemit të adresave kërkon informacione të rregullta dhe mirëmbajtje të vazhdueshme. Sikur vetëm një prej elementeve të adresës të ndryshojë e gjithë adresa quhet e ndryshuar.

Elementet e adresës mund të ndryshojnë jo vetëm karakteristikat e tyre por edhe gjeometrinë. Sa herë që kemi një ndryshim të njërit element kontrollohen dhe përditësohen të gjitha atributet që lidhen dhe kanë ndikuar në këtë ndryshim.

Ndryshimi i adresave bëhet duke u bazuar në Ligjin për Sistemin e Adresave dhe UA 17/2019.

Për më shumë informacione rreth ndryshimeve të mundshme, shihni kapitullin - Cikli i jetës së adresave.

8. Regjistri i adresave

Në regjistrin e adresave bëhet regjistrimi i emërtimeve të të gjitha ZQP-ve dhe adresave brenda territorit të Komunës. Regjistrimi i referohet dokumentit bazë të aprovimit të emrit dhe numrit që është baza për hedhjen e informacionit në regjistrin e adresave.

Regjistri i adresave duhet të jetë në çdo kohë i çashtëm nëpërmjet një kombinimi të emrit të ZQP-së dhe numrit të adresës së objektit, dhe të jep mundësinë e marrjes së informacionit të plotë rreth objektit të kërkuar në regjister.

Në regjistrin e adresave, të dhënat e çdo objekti janë të lidhura me të dhënat për emërtimin dhe numërtimin.

Përgjegjësi i ZPU-së në komunë duhet të sigurohet që të kryhet një përditësim

apo rifreskim i vazhdueshëm i informacionit në regjistrin e adresave.

Një element i rëndësishëm është që çdo ndryshim në regjistrimin e adresave i korrespondon një dokumenti bazë shoqërues. Kjo do të thotë që vendimi për numrin dhe emrin e rrugës janë baza për të bërë ndryshime në regjistrimin e adresave.

Duke përdorur një regjistër qendror të adresave, shmanget krijimi i disa data bazave me të dhënat e adresave, dhe për pasojë, mirëmbajtja e të dhënave për adresat është më e thjeshtë.

Për shkak se çdo Drejtori në Komunë përdor të njëjtat të dhëna për adresat, punonjësit e administratës dhe vetë qytetarët janë në gjendje të vërejnë gabime nëse ka në regjistrin e adresave.

Megjithatë, atyre nuk u lejohet që të ndryshojnë informacionin e adresave, por janë të detyruar që të informojnë autoritetin përkatës që është përgjegjës për regjistrimin e adresave në mënyrë që ky autoritet të hetojë dhe të ndryshojë të dhënat mbi adresën nëse verifikimi del se është i saktë. Ky ndryshim do të reflektohet gjithashtu edhe në regjistrat e tjerë që kanë komunikim me regjistrin e adresave.

Dhënia e komenteve për informacionin është një pjesë e rëndësishme e mirëmbajtjes së sistemit. Është gjithashtu në interesin e përdoruesve që regjistri i adresave të jetë i saktë dhe i plotë dhe prandaj nuk duhet të hezitet për të raportuar problematikat.

8.1 Elementet e një adrese në regjistrin e adresave

Adresa konsiston në emrin e një rrugë, një numër objekti (dhe numrat vartës) dhe vendin e banimit. Emri i ZQP-së, një numër dhe vendi i banimit janë tre elementet kryesore të regjistrimit të adresës. Për secilin prej këtyre elementeve do të regjistrohet informacion i detajuar. Secili nga këto tre elemente mund të ndryshojë në regjistrim në mënyrë të pavarur nga të tjerët.

Për shembull, nëse ndryshon një numër, emri i ZQP-së mund të mbetet akoma i njëjtë dhe në të kundërtën kur ndryshon emri i rrugës nuk është e thënë që të ndryshojnë patjetër edhe numrat e ndërtesave të kësaj rruge. Të gjitha karakteristikat e elementeve të adresës janë të rëndësishme të regjistrohen por më të rëndësishmet janë: adresa, ZQP, vendi i banimit, vendndodhja (gjeometria) e secilit element dhe data e krijimit të një adrese. Më poshtë jepen disa nga karakteristikat më të

rëndësishme në lidhje me elementet e adresave:

- **Zonat e qarkullimit publik**

- Emri i rrugës/bulevardit/autostradës /sheshit/parkut
- Lloji i ZQP
- Kodi i ZQP
- Gjeometria e ZQP
- Komuna dhe vendbanimi
- Kodi postar
- Numrat e adresave që i përkasin kësaj ZQP në të dy krahët, midis kryqëzimeve
- Kufizimet në rrugë (kthimet djathtas/majtas)
- Numri i traseve
- Tabelat në zonat e qarkullimit publik
- Data e regjistrimit të parë
- Data e ndryshimit dhe komentet
- Data e mbylljes së regjistrimit

- **Numri i adresës (Objekti i adresueshëm)**

- Numri i adresës
- Emri i objektit
- Kodi unik i objektit
- Lloji i objektit
- Numri i kateve
- Numri i banesave /zyrave
- Kodi i ZQP / emri
- Komuna dhe vendbanimi
- Kodi postar
- Gjeometria
- Koordinatat (X,Y) e çdo adrese
- Blloku/Lagja (nëse ka)
- Data e regjistrimit të parë
- Data e ndryshimit (nëse ndodh)
- Data e mbylljes së regjistrimit

- **Vendbanimi**
 - Emri (lagja)
 - Emri (qyteti/fshati)
 - Emri (komuna)
 - Gjeometria (e zonës)
 - Data e regjistrimit të parë
 - Data e mbylljes së regjistrimit
- **Të dhëna të tjera gjeografike**
 - Koordinatat (X,Y) e çdo adrese
 - Pikat e interesit
 - Kufijtë e qyteteve /fshatrave
 - Kufijtë e komunave
 - Kufijtë e zonave të kodit postar
 - Hidrografia
 - Linjat hekurudhore
 - Kufiri i shtetit

9. Cikli i jetës së adresave

Synimi i AKK-së është që të krijohet një sistem i qëndrueshëm i adresave me përditësim sistematik dhe të vazhdueshëm. Në kapitujt e parë është vënë në dukje se është shumë e rëndësishme të mirëmbahet informacioni në regjistrin e adresave. Për ta bërë këtë, nevojitet të përdoret aplikacioni i regjistrit të adresave - SIRA. Në Kosovë adresat caktohen nga ZPU, e cila është përgjegjëse për nxjerrjen e lejeve të ndërtimit. Për këtë arsye, informacioni që nevojitet për ndryshimin e adresës lëshohet nga e njëjta zyrë.

Ndryshimet që i ndodhin një adrese reflektohen si elemente në *ciklin e jetës së adresave*. Në regjistrin e adresave është e mundur që:

- Të krijohet një adresë e re
- të ndryshohet adresa
- të fshihet adresa.

Edhe nëse adresa mbyllet është përsëri e mundur që të ruash një histori të adresës

së vjetër në regjistrin e adresave.

Këto tri elemente të ciklit të jetës së adresave burojnë nga ndryshimet përkatëse që mund t'i ndodhë secilës prej tyre.

9.1 Cikli i adresave/Objektit

Regjistrimi i një adrese të re:

Përcaktohet një adresë e re me anë të një dokumenti zyrtar (vendimi për numrin). Regjistrohet një adresë e re në regjistër me emrin e rrugës, numrin e hyrjes në objekt, vendndodhjen, dhe datën.

Ndryshimi i një adrese:

Për shembull dy apartamente shkrihen në një ose anasjelltas. Përcaktohet një adresë e re; adresa e vjetër mbyllet me anë të një dokumenti zyrtar (vendimi për numrin). Pjesa tjetër e adresave në objekt apo në të njëjtën rrugë mbeten ashtu siç ishin. Regjistrimi i adresës së vjetër (me datë) dhe nisja e një adrese të re digjitalizohet në regjistër.

Rivendosja e tabelave me numra të rinj:

Rivendosja e numrave bëhet me anë të një dokumenti zyrtar (vendimi për numrin).

Fundi i një adrese:

Kjo ndodhë për shkak të prishjes, zjarrit, katastrofës etj.

Adresat nuk ekzistojnë më dhe mbyllen me anë të një dokumenti zyrtar (vendimi për numrin). Mbyllja e adresave të vjetra ruhet me datën përkatëse.

9.2 Cikli i një zone të qarkullimit publik

Planifikimi për një zonë të re ndërtimesh:

Emrat e ZQP-ve jepen me një dokument zyrtar të shoqëruar me hartë (vendimi për emrin e rrugës).

Në regjistrin e adresave regjistrohet një zonë e re publike (p.sh rrugë), me vendndodhjen, emrin, kodin, datën dhe elementet tjera.

Ndryshim i formës ose gjatësisë së një pjese të ZQP-së:

Kjo bëhet me anë të një dokumenti zyrtar të shoqëruar me hartë (vendimi për emrin e rrugës). Në regjistër (hartë) bëhet ndryshimi i gjeometrisë /vendndodhjes së rrugës.

Shkrija e disa ZQP-ve ose ndarja e një ZQP në disa pjesë:

Emërohet ZQP e re dhe ZQP e vjetër tërhiqet me një dokument zyrtar (vendimi për emrin e rrugës). Në regjistrin e adresave (hartë) bëhet hedhja e ZQP së re dhe mbyllja (fshirja) e një të vjetre.

Riemërtimi i një pjese të ZQP-së:

Riemërtimi bëhet me anë të një dokumenti zyrtar (vendimi për emrin e rrugës). Në regjistër bëhet ndryshimi i emrit dhe emri i vjetër ruhet në regjistër.

Fundi i një pjese të ZQP-së

Pjesa e territorit publik tërhiqet me një dokument zyrtar (vendimi për emrin e rrugës). Në regjistër mbyllet emri i një rrugë të vjetër duke vendosur një datë mbylljeje.

10. Vendosja e tabelave të emrave të ZQP-ve dhe numrave

Vendosja e tabelave të emrave të ZQP-ve dhe numrave në rrugët dhe objektet përkatëse duhet t'i plotësoj kriteret e parapara me Ligjin për Sistemin e Adresave dhe UA, por gjithnjë duke pas përballë situatat normale për leximin e tyre dhe situatat emergjente të leximit të tyre. Në rast emergjence, çdo sekondë është e çmuar. Kjo do të jetë e qartë nëse e analizojmë p.sh. rastin e një shoferi, polici, zjarrfikësi, sepse ata duhet në shpejtësi ta lexojnë adresën. Vendosja e tabelave me numrat e adresave duhet të na kujtoj situatën e një shoferi të një automjeti emergjence p.sh. zjarrfikësi, ambulanca: sa do të jetë në gjendje shoferi i ambulancës në rast emergjence duke drejtuar automjetin me shpejtësi të shikojë dhe të lexojë numrin e adresës suaj ndoshta në errësirë, në dimër, apo edhe në kohë të keqe.

Përlllogaritja e numrit të nevojshëm të tabelave që duhen prodhuar, pozicionit të tyre, dhe formës dhe llojit të bëhen në përputhje me rregullat dhe kriteret e përcaktuara në Udhëzimet Administrative nr. 15/2019 dhe 18/2019 .

Më poshtë jepen të përmbledhura parimet kryesore që duhet t'ju udhëheqin gjatë punës për përgatitjen e informacionit rreth tabelave me emra, me numra të adresave dhe instalimit të tyre në territorin e Komunës:

10.1 Parimet kryesore për tabelat e emrave

- Brenda territorit të Republikës së Kosovës tabelat e emrave të ZQP-ve të shkruhen në tabela standarde.
- Duhet të sigurohen që tabelat e emrave të ZQP-ve që u caktohen seksioneve të ZQP të jenë të dukshme qartë dhe me dendësi të mjaftueshme. Banorët dhe vizitorët në Kosovë duhet të orientohen lehtësisht.
- Emrat në tabela të jenë lehtësisht të lexueshme nga ZQP ku kalojmë me këmbë apo automjet.
- Në rrugët që qarkullojnë mjetet automobilistike, tabelat me emrat e rrugëve duhet të vendosen në shtylla në krah të rrugës në mënyrë të tillë që të jenë përherë të dukshme.
- Në kryqëzim rrugësh tabelat me emrat duhet të vendosen në shtylla për çdo drejtim ku automjetet qarkullojnë.
- Tabelat me emrat e rrugëve të vendosur në shtylla duhet të jenë të shkruara në të dyja anët e tabelës dhe në raste kur vendosen në mur ose në udhëkryq “T” emri i ZQP shkruhet vetëm në njërin anë.
- Ka raste kur mund të vendosen të dyja llojet e tabelave për emrin e ZQP në shtyllë edhe në mur
- Në zonat ku mjetet e qarkullimit nuk janë të lejuara dhe në rrugët që kanë distanca të shkurtra midis tyre dhe ka trotuare të ngushtë tabelat me emrat mund të vendosen në ndërtesë. Shikueshmëria e tabelave duhet pasur parasysh dhe duhet mirëmbajtur në rastet e pemëve / bimëve / objekteve që ndodhen pranë ndërtesës që mund të pengojnë shikueshmërinë e tyre.
- Në rrugët me trafik të kufizuar tabela e emrit mund të shoqërohet edhe me një shenjë me shigjetë poshtë tabelës së emrit të rrugës për të treguar që rruga vazhdon në të dy krahët e kryqëzimit.
- Kur bulevardi ose rruga ndërpritet nga një bulevard ose rrugë tjetër kryesore, shesh apo park, ose kur bulevardi apo rrugët janë të gjata, atëherë tabelat duhet të vendosen në çdo kryqëzim rrugësh por mund të vendosen edhe në pika të tjera të dukshme përgjatë vazhdimit të bulevardit ose rrugës.

10.2 Parimet kryesore për tabelat e adresave

- Brenda çdo vendbanimi numrat rendorë të adresave të shkruhen në tabela standarde.
- Tabelat me numrat e adresave duhet të vendosen gjithmonë (përjashtuar raste të veçanta) përballë rrugës që pika hyrëse në objekt është adresuar dhe të jenë lehtësisht të dallueshme.
- Në rastet kur objekti nuk ka përfunduar, tabela me numrin do të vendoset nga personi i autorizuar menjëherë pas përfundimit të objektit. Objekti duhet të jetë i pajisur me tabelë para se banori të fillojë të jetojë në banesë.
- Nëse shihet e arsyeshme tabelat vendosen edhe në objektet e mëdha me funksion banimi dhe biznesi, ndërsa në objektet me shumë kate mund të vendosen edhe tabela kolektive për numrin e banesave /zyrave që ndodhen në një hyrje apo edhe në një kat. Këto tabela duhet të vendosen edhe në pikën hyrëse të objektit ose të katit, zakonisht në katin e parë dhe të jenë në vende të dukshme si pranë ashensorit, pranë shkallëve, apo në pjesën balllore kur hyn në objekt.
- Në tabelat kolektive numrat duhet të fillojnë nga më i vogli tek më i madhi, p.sh. tabela me adresat (1 – 23) duke treguar që banesat/zyrat me numër nga 1 - 23 ndodhen në këtë hyrje.
- Tabela kolektive duhet të vendoset edhe në zona rurale kur shtëpitë janë shumë larg nga rruga. Tabela kolektive e vendosur buzë rrugës bën të dukshme numrat e shtëpive të grumbulluara larg nga rruga kryesore, pa qenë nevoja të shkosh afër shtëpive.
- Më hollësisht për formën, përmasat, llojin dhe lartësinë e shkrimit në tabela dhe mënyrën e vendosjes së tyre lexoni Udhëzimet Administrative nr. 15/2019 dhe 18/2019 dhe shtojcat përkatëse.

11. Shtojcë: Forma e Certifikatës së Adresës



Republika e Kosovës
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

CERTIFIKATA E ADRESËS ZYRTARE

Numri serik:	_____
Data dhe koha e lëshimit:	_____
Komuna:	_____
Zyra e Planifikimit Urban:	_____
Printuar nga:	_____

ADRESA ZYRTARE E PERSONIT

Emri dhe Mbiemri	Nr. Personal	Emri i rrugës	Nr. i hyrjes	Nr. i katit	Nr. i banesës	Kodi postar	Vendbanimi	Komuna

Personi zyrtar:

V. V.

Ju mund të gjeni adresën tuaj në internet në www.geoportal.rks-qov.net/filimi